



# **FLETORJA ZYRTARE**

## **E**

# **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

|              |             |               |
|--------------|-------------|---------------|
| <b>Nr. 3</b> | <b>2000</b> | <b>Shkurt</b> |
|--------------|-------------|---------------|

### **P Ë R M B A J T J A**

|                                      |                                                                                                                                                                                                                                                      |    |
|--------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Ligj nr.8571<br>datë 27.1.2000       | Për miratimin e Dokumentit të Politikës së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë                                                                                                                                                                     | 19 |
| Ligj nr.8572<br>datë 27.1.2000       | Për miratimin e Dokumentit të Strategjisë së Sigurimit të Republikës së Shqipërisë                                                                                                                                                                   | 43 |
| Vendim i KM<br>Nr.47, datë 17.2.2000 | Për miratimin e Memorandumit Teknik të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike të Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të jashtme të Italisë, “Për projektin urë për asistencë të menjëhershme për impiantin e ujit të pijshëm në Bovillë” | 65 |

**LIGJ**  
**Nr.8571, datë 27.1.2000**

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 12, 78, 83 pika 1, 168 dhe 169 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

Politika mbrojtjes synon përdorimin e të gjitha mjeteve politike e ushtarake për mbrojtjen e interesave kombëtarë dhe për kryerjen e detyrave kushtetuese, nëpërmjet kërcënimit për përdorimin e forcës ose përdorimit të saj.

Politika e mbrojtjes synon përgatitjen e vendit dhe të Forcave të Armatosura për integrimin në strukturat euroatlantike të sigurimit.

Neni 2

Zbatimi i politikës së mbrojtjes është përgjegjësi e të gjitha institucioneve qendrore e vendore.

Neni 3

Miratohet Dokumenti i Politikës së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Numri i Forcave të Armatosura në kohë paqeje të jetë 31 000 veta, ndërsa në kohë lufte 120 000 veta. Ndryshimet në numrin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Shtabit të Përgjithshëm bëhen me ligj, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përgatisë projektligjet e nevojshme sipas parashikimeve dhe afateve të vendosura në Dokumentin e Politikës së Mbrojtjes dhe të miratojë aktet nënligjore, të nevojshme për zbatimin e këtij Dokumenti.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Skënder Gjinushi**

POLITIKA E MBROJTJES  
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËRMBAJTJA

|    |                                                                    |    |
|----|--------------------------------------------------------------------|----|
|    | Faqe                                                               |    |
|    | I. MJEDISI I SIGURIMIT DHE I MBROJTJES.....                        | 1  |
|    | - Rreziqet dhe kërcënimet e jashtme.....                           | 1  |
|    | - Rreziqet dhe kërcënimet e brendshme.....                         | 2  |
|    | II. KUADRI I POLITIKËS SË MBROJTJES .....                          | 2  |
|    | - Objektivat e politikës së mbrojtjes .....                        | 3  |
|    | - Parimet bazë ku mbështetet politika e mbrojtjes.....             | 4  |
|    | - Koncepti i mbrojtjes .....                                       | 4  |
|    | III. FORCAT E ARMATOSURA, MISIONI DHE DETYRAT... ..                | 5  |
|    | - Komandimi e drejtimi në Forcat e Armatosura.....                 | 6  |
|    | - Forcat tokësore.....                                             |    |
| 8  | - Forcat ajrore.....                                               |    |
| 10 | - Forcat detare.....                                               |    |
| 12 | - Klasifikimi i forcave dhe detyrat e tyre .....                   | 14 |
|    | - Komandat mbështetëse .....                                       |    |
| 14 | - Policia ushtarake .....                                          | 15 |
|    | - Riorganizimi i Ministrisë së Mbrojtjes.....                      | 15 |
|    | IV. PLANIFIKIMI I FORCËS DHE I BURIMEVE.....                       | 15 |
|    | - Personeli .....                                                  |    |
| 16 | - Rezervistët.....                                                 |    |
| 16 | - Përgatitja e personelit .....                                    |    |
| 17 | - Buxheti i Mbrojtjes .....                                        | 18 |
|    | - Kapacitet mbrojtës dhe modernizimi i Forcave të Armatosura. .... | 19 |
|    | - Planizimi i zbatimit të strukturës së re .....                   |    |
| 19 |                                                                    |    |
|    | PËRFUNDIME .....                                                   |    |
| 20 |                                                                    |    |

## I. MJEDISI I SIGURIMIT DHE I MBROJTJES

1. Zhvillimet botërore e rajonale gjatë 10-vjeçarit të fundit sollën një epokë të re në mjedisin strategjik ndërkombëtar të sigurimit. Blloqet antagonistë dhe linja e konfrontimit të luftës së ftohtë nuk ekzistojnë më. Megjithatë, komuniteti ndërkombëtar dhe sidomos ai evropian po përballet me sfida të reja. Europa ende karakterizohet nga pasiguri e konflikte të armatosura. Ajo, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, përballet me destabilizim, në veçanti në Ballkan, në Europën Juglindore, në Rajonin e Mesdheut, në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën Veriore. Në Ballkan, pas konfliktit të Kosovës, po fillojnë, nën udhëheqjen e vendeve demokratike perëndimore, procese pozitive që në plan afatgjatë, mund të sjellin stabilitet, integritet, bashkëpunim dhe prosperitet.

Republika e Shqipërisë lloji një rol të veçantë në zgjidhjen e konfliktit të Kosovës, rol që iu njoh edhe nga komuniteti ndërkombëtar e NATO. Kjo ka rritur interesimin për të, ka përmirësuar imazhin e saj dhe ka shtuar shanset për integritetin euroatlantik.

Republika e Shqipërisë është angazhuar në forcimin e gjendjes së brendshme për të tejkaluar vështirësitë e krijuara nga destabilizimi i brendshëm dhe shkatërrimi i institucioneve (përfshirë Forcat e Armatosura) gjatë vitit 1997 dhe ngjarjet e shtatorit 1998. Këto pasoja do të kenë ndikimet e tyre edhe në çështjet e mbrojtjes edhe në vitet e ardhshme.

## RREZIQET DHE KËRCËNIMET E JASHTME

3. Gjendja e sotme gjeopolitike dhe gjeoekonomike evidencon një sërë rreziqesh e kërcënimesh për interesat dhe sigurimin e vendit. Këto rreziqe e kërcënime janë komplekse e kaotike. Ndër to mund të përmendim të tilla, si: konfliktet rajonale, pikat e nxehta në Europën Juglindore, nacionalizmi, kontrasti ekonomik Lindje-Perëndim, përhapja e armëve të dëmtimit në masë, terrorizmi, trafiket e paligjshme, fatkeqësitë me origjinë natyrore e teknologjike.

4. Gjendja pas konfliktit në Kosovë dhe prania ushtarake e NATO-s në Kosovë dhe në Shqipëri ka pakësuar kërcënimin e drejtpërdrejtë ushtarak në kufijtë veriorë, por nuk e ka eliminuar atë. As konflikti në Kosovë dhe as ai në Bosnjë nuk janë zgjidhur përfundimisht.

5. Nacionalizmi, grindjet dhe urrejtjet etnike, të cilat siç ka treguar përvoja e kohëve të fundit mund të marrin edhe formën e konflikteve të armatosura, do të vazhdojnë të mbeten një rrezik për Ballkanin.

6. Rreziqet i shtojnë edhe disa probleme specifike të rajonit tonë si: zhvillimi i ulët ekonomik, mospërfshirja e tij në proceset e pakësimit të armëve dhe prapambetja e ndonjë vendi të rajonit në përfshirjen në proceset demokratike dhe ato integruese.

Politika e mbrojtjes merr parasysh shumëllojshmërinë e rreziqeve e të kërcënimeve. Për përballimin e tyre parashikon edhe kohën e lajmërimit dhe të përgatitjes për luftë. Koha e lajmërimit është koha prej çastit kur zbulohet përgatitja e një agresioni kundër Republikës së Shqipërisë deri në marrjen e vendimit nga udhëheqja strategjike e vendit për t'u përgatitur për kundërvënien me mjete ushtarake. Koha e përgatitjes është koha prej marrjes së vendimit strategjik për përgatitje deri në çastin e parashikuar për fillimin e armiqësisë.

## RREZIQET DHE KËRCËNIMET E BRENDSHME

7. Stabiliteti i brishtë në vend ka pasojat e veta negative në sigurinë dhe mbrojtjen. Brishtësia e institucioneve, mungesa e qetësisë, e rendit publik dhe e konsensusit politik për problemet e mëdha e dëmtojnë seriozisht sigurinë e vendit.

8. Zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik krijon probleme sociale. Ai ka ndikimet e veta negative

në patriotizmin dhe moralin qytetar, si dhe në rendin e rregullin në vend, nxitjen e terrorizmit, të krimit të organizuar, të trafikëve të paligjshme (të drogës e të njerëzve), të kontrabandës, të korrupsionit, të prostitucionit, të ndotjes së mjedisit dhe të dëmtimit të pronës së qytetarëve e të shtetit. Këto plagë të shoqërisë i favorizojnë edhe terrorizmi ndërkombëtar dhe trafiket e paligjshme, të cilat janë të pranishme në rajonin tonë.

9. Lëvizjet e pakontrolluara të popullsisë jashtë dhe brenda vendit kanë varfëruar potencialet njerëzore e intelektuale të vendit dhe kanë krijuar vështirësi në plotësimin e strukturave të forcave me burime njerëzore.

10. Motivimi i qytetarëve për të marrë pjesë në sigurinë e mbrojtjes së vendit është i ulët.

Republika e Shqipërisë ka edhe shanse e mundësi për sigurinë e mbrojtjes si : prania e NATO-s në Shqipëri dhe në Kosovë, angazhimi i botës demokratike për stabilitet, zhvillim ekonomik dhe integrimin euroatlantik të Ballkanit dhe pozicioni i saj i favorshëm gjeografik.

## II. KUADRI I POLITIKËS SË MBROJTJES

11. Politika e mbrojtjes në thelb ka mbrojtjen e interesave jetësore të vendit si: mbrojtjen e sovranitetit, të pavarësisë, të integritetit territorial, të rendit kushtetues dhe të jetës së qytetarëve shqiptarë. Ajo e realizon këtë nëpërmjet mbajtjes së forcave të armatosura e përdorimit të burimeve të vendit për mbrojtje dhe bashkëpunim me NATO-n, me SHBA-në, me Bashkimin Europian, me Bashkimin Europiano-Perëndimor, me Organizatën e Sigurimit e të Bashkëpunimit në Europë dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

12. Politika e mbrojtjes bazohet në përkrahjen e opinionit publik e të shtetit shqiptar dhe në konsensusin e forcave politike. Ajo është e domosdoshme për mobilizimin e burimeve njerëzore e materiale për përballimin e rreziqeve dhe të kërcënimeve. Bashkëpunimi civilo-ushtarak në problemet themelore të sigurimit e të mbrojtjes së vendit, si dhe ndihma e Forcave të Armatosura për popullsinë civile vlerësohen si parësore në politikën e mbrojtjes.

13. Forcat e Armatosura janë pjesë e shoqërisë demokratike shqiptare. Politika e mbrojtjes mbështetet në konsensusin publik dhe politik, për të siguruar përkushtimin e qytetarëve dhe të ushtarakëve për çështjet e mbrojtjes. Integrimi i Forcave të Armatosura në shoqëri do të arrihet nëpërmjet ndërtimit të marrëdhënieve të drejta civilo-ushtarake : me legjislativin, ekzekutivin, median, sipas standardeve të shoqërive demokratike, si dhe nëpërmjet transparencës dhe informimit të publikut për veprimtarinë e këtyre forcave.

14. Shoqëria mbron me status të veçantë ushtarakët për privacionet e tyre për shkak të shërbimit në Forcat e Armatosura. Presupozohet harmonizimi i lirisë dhe i të drejtave të përcaktuara në Kushtetutë me kufizimet që sjell kryerja e misionit në këto forca. Ky harmonizim arrihet nëpërmjet përgatitjes, kujdesit për njerëzit, kushteve të mira të jetesës, edukimit atdhetar, disiplinës, zbatimit të ligjit e rregullit.

15. Kuptimi i rolit dhe i vendit të Forcave të Armatosura në shoqërinë demokratike dhe i përgjegjësisë nga pjesëtarët e këtyre forcave si ushtarë e qytetarë vlerësohet nga politika e mbrojtjes si një nga përgjegjësitë parësore të institucioneve publike dhe të komandave ushtarake. Nderi i ushtarakut, dashuria ndaj atdheut dhe përkushtimi ndaj detyrës do të jenë në bazë të etikës ushtarake.

Politika e mbrojtjes e shikon përgatitjen e një pakete ligjore për Forcat e Armatosura si një nga detyrat kryesore për t'i pozicionuar drejt ato në shoqërinë tonë demokratike.

16. Politika e Mbrojtjes mbështet angazhimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar, si pjesëmarrjen në nismën e Partneritetit për Paqe dhe në Paktin e Stabilitetit të Europës Juglindore; respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të pranura nga shteti ynë; ndihmesën për forcimin e stabilitetit rajonal; mbështetjen e nismave për pakësimin e armatimeve në rajon, përfshirë edhe nënshkrimin në një kohë të përshtatshme të Traktatit të Armëve Konvencionale në Europë, si dhe pjesëmarrjen në operacionet e mbështetjes së paqes në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve, me Aktin Final të Helsinkit dhe me dokumente të tjera të pranura nga shteti ynë.

Pakti i Stabilitetit të Europës Juglindore shikohet nga politika e mbrojtjes si një synim drejt një Europe të pandarë dhe demokratike, drejt bashkëpunimit dhe bashkëjetesës në rajon dhe drejt një të ardhmeje pa konflikte etnike.

Politika e mbrojtjes nëpërmjet planit të veprimit për anëtarësim dhe pjesëmarrjen në partneritetin e zgjeruar e operacional do të konkretizojë synimet dhe objektivat e veta për ta përgatitur vendin dhe Forcat e tij të Armatosura për integrim në NATO.

## OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË MBROJTJES

17. Duke u nisur nga rreziqet dhe nga kërcënimet, politika e mbrojtjes përcakton si objektiva kryesorë:

- mbrojtjen e pavarësisë, e sovranitetit e të integritetit territorial të vendit, të jetës së qytetarëve tanë dhe ndihmesën për paqen e stabilitetin në rajon;
- zhvillimin e kapaciteteve të mjaftueshme mbrojtëse për të mënjeluar një sulm të armatosur apo agresion ushtarak kundër Republikës së Shqipërisë, si dhe nxitjen e bashkëpunimit e të proceseve integruese;
- rivendosjen e integritetit territorial, nëse preket, nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme për rimarrjen e territorit të kapur nga armiku.

## PARIMET BAZË KU MBËSHTETET POLITIKA E MBROJTJES

18. Politika e mbrojtjes mbështetet në disa parime bazë:

- edukimin atdhetar të ushtarakëve dhe të qytetarëve shqiptarë për të rritur pjesëmarrjen e tyre në realizimin e objektivave të politikës së mbrojtjes dhe sigurimin e vullnetit kombëtar për të bërë luftën;
- zgjidhjen paqësore të konflikteve e mbështetjen e nismave për sigurimin e përbashkët, në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe me dokumentet e ligjet ndërkombëtare;
- mjaftueshmërinë e mbrojtjes dhe mbështetjen e mbrojtjes me burime, duke ruajtur barazpeshën midis kërkesave të mbrojtjes e mundësive financiare, ekonomike, demografike dhe intelektuale për përmbushjen e këtyre kërkesave;
- shfrytëzimin e burimeve të vendit e të gjithë elementëve të fuqisë kombëtare dhe të terrenit, si dhe përgatitja e këtij të fundit për mbrojtje e për kryerjen e operacioneve luftarake;
- përgatitjen e vendit dhe të Forcave të Armatosura për integrim në strukturat euroatlantike të sigurimit, duke marrë pjesë në programin e Partneritetit për Paqe dhe në Procesin e Planifikimit e të Rishikimit të Partneritetit dhe duke realizuar Programin Individual të partneritetit për Paqe;
- lidhjen e aleancave e të marrëveshjeve ushtarake ndërkombëtare e rajonale në interes të përgatitjes së vendit për mbrojtje dhe ruajtjen e sovranitetit në lidhjen e këtyre marrëveshjeve, duke respektuar Kushtetutën dhe legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;
- drejtimin civil demokratik të Forcave të Armatosura dhe garantimin e tij, duke hartuar kuadrin e plotë ligjor e institucional;
- transparencën në planifikimin e mbrojtjes.

## KONCEPTI I MBROJTJES

19. Kapacitetet tona ushtarake duhet të sigurojnë forcën e mjaftueshme për mbrojtjen e vendit. Ato duhet të bindin çdo agresor të mundshëm se nuk është e leverdisshme të sulmohet Shqipërinë, pasi dëmet do të jenë më të mëdha se fitimet. Përpjekjet kryesore për mbrojtje do të përqendrohen në drejtimet e kërcënuara në Veri të vendit. Struktura e Forcave të Armatosura dhe përhapja e tyre do të sigurojë reagimin në përpjesëtim me shkallëzimin e veprimit nga armiku potencial.

Prania e përhapur me forca për të realizuar mbrojtjen sa më afër vijës së kufirit dhe shfrytëzimi i

terrenit malor për të organizuar mbrojtjen pozicionale në drejtimet e kalimit, do të luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e konceptit tonë të mbrojtjes.

20. Përcaktimi në kohë dhe lajmërimi i rreziqeve do t'i japë Forcave të Armatosura dhe vendit kohën e nevojshme për të përballuar të papriturat dhe për t'u përgatitur për mbrojtje. Kërkohej që Forcave të Armatosura t'u jepen 3 muaj kohë për t'u përgatitur për operacionet luftarake. Për këtë zbulimi strategjik dhe kontrolli i hapësirave tokësore, ajrore e detare shikohen si detyra të rëndësishme. Kjo së bashku me ngritjen e strukturave solide ushtarake dhe aktivizimin e tyre në kohën dhe në vendin e duhur në raport me shkallëzimin e rreziqeve, do të sigurojë reagimin tonë të efektshëm ndaj veprimeve të armikut potencial.

21. Zbatimi i konceptit të mbrojtjes është detyrë e Doktrinës Ushtarake, e cila do të përcaktojë se si do të përdoren Forcat e Armatosura në operacione luftarake, humanitare dhe të mbështetjes së paqes.

22. Forcat e Armatosura do të ristrukturohen për të qënë në gjendje të zbatojnë konceptin e mbrojtjes dhe për t'u bërë të ndërveprueshme me strukturat e NATO-s.

Politika e Mbrojtjes parashikon që NATO dhe vendet anëtare të saj do të jenë aleatë në zbatimin e konceptit të tyre të mbrojtjes. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ushtarak me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera të NATO-s, të Bashkimit Europian, të Bashkimit Europiano-Perëndimor dhe ato pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe.

### III. FORCAT E ARMATOSURA, MISIONI DHE DETYRAT

23. Veprimtaria e Forcave të Armatosura zhvillohet në përshtatje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet.

24. Forcat e Armatosura do të ristrukturohen për t'iu përgjigjur kërcënimeve e rreziqeve ndaj mbrojtjes së vendit, për të kapërcyer pasojat e ngjarjeve të vitit 1997 dhe për t'u bërë të ndërveprueshme me ushtritë e vendeve të NATO-s.

25. Misioni i Forcave të Armatosura do të jetë mbrojtja e sovranitetit, e integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë dhe e rendit kushtetues.

Në zbatim të këtij misioni ato do të kryejnë këto detyra kryesore :

- mbrojnë interesat jetësore të Republikës së Shqipërisë: tërësinë territoriale, sovranitetin dhe rendin kushtetues;

- kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit rajonal, duke dhënë ndihmesë në parandalimin e zgjidhjen e krizave, si dhe duke u përgatitur për t'u integruar në strukturat euroatlantike;

- marrin pjesë në operacionet mbështetëse të paqes të mandatuara nga Kombet e Bashkuara, OSBE-ja, NATO-ja dhe Bashkimi Europiano- Perëndimor;

- ndihmojnë popullsinë në rast fatkeqësish natyrore e teknologjike, epidemish dhe në rast lufte, duke kryer operacione humanitare.

Për zbatimin e misionit dhe të detyrave të tyre Forcat e Armatosura bashkëveprojnë me trupat e kufirit, të cilat kontrollojnë kufirin e garantojnë respektimin e të drejtës ndërkombëtare e të marrëveshjeve të nënshkruara nga shteti shqiptar dhe forcat e tjera të Ministrisë së Rendit.

### KOMANDIMI E DREJTIMI NË FORCAT E ARMATOSURA

26. Republika e Shqipërisë është shtet demokratik dhe vendimet strategjike për çështjet e sigurimit e të mbrojtjes merren nga organet legjitime (siç përcaktohen me Kushtetutë dhe me ligj).

27. Kuvendi është organi më i lartë legjislativ, miraton ligjet për Forcat e Armatosura, buxhetin e mbrojtjes, madhësinë e forcave dhe programet e zhvillimit të tyre. Kuvendi shpall gjendjen e luftës, gjendjen e jashtëzakonshme dhe autorizon organet përkatëse të merren me emergjencat ose situatat e krizave. Ai ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare ushtarake dhe për aleanca.

28. Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe, në rast agresioni, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, shpall gjendjen e luftës. Në kohë paqeje drejton Forcat e Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte drejton nëpërmjet

Komandantit të Forcave të Armatosura, i cili emërohet nga Presidenti me propozim të Kryeministrit.

29. Këshilli i Sigurimit është organ këshillimor i Presidentit.

30. Këshilli i Ministrave është organi më i lartë ekzekutiv. Ai propozon ligje dhe zbaton ligjet që miraton Kuvendi, përcakton drejtimet kryesore të politikës shtetërore dhe nxjerr akte normative që kanë fuqi ligjore për marrjen e masave të përkohshme.

31. Kryeministri është funksionari më i lartë i pushtetit ekzekutiv. Ai paraqet programin politik të Këshillit të Ministrave dhe përbërjen e tij. Ai koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës shtetërore dhe përgjigjet për to. Kryeministri nxjerr urdhra.

32. Ministri i Mbrojtjes është anëtar i Këshillit të Ministrave e i Këshillit të Sigurimit dhe autoriteti më i lartë i Ministrisë së Mbrojtjes. Në kohë paqeje Presidenti i Republikës ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes. Ministri i Mbrojtjes përgjigjet për organizimin e funksionimin e Forcave të Armatosura për plotësimin e misionit nga ana e tyre, për administrimin e buxhetit të mbrojtjes dhe për realizimin e politikës së mbrojtjes.

Zëvendësministri i Mbrojtjes, në mungesë të Ministrit, e përfaqëson atë në të gjitha aspektet. Ai mbështet Ministrin në drejtimin e Ministrisë.

33. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është eprori më i lartë ushtarak në Forcat e Armatosura dhe mban gradën më të lartë. Ai është përgjegjës përpara Presidentit të Republikës dhe Ministrit të Mbrojtjes për përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të Forcave të Armatosura, si dhe për drejtimin dhe organizimin e operacioneve ushtarake. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është këshilltari më i lartë ushtarak i Ministrit dhe i Presidentit.


Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm, në mungesë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, e përfaqëson atë në të gjitha çështjet.

34. Komandantët e Forcave janë edhe shefa shërbimesh për forcat e tyre. Ata janë eprorë disiplinorë për forcat e tyre: tokësore, ajrore e detare dhe përgjigjen për gatishmërinë e tyre operacionale. Si shefa shërbimesh ata kanë të drejtë të raportojnë drejtpërdrejt te Ministri i Mbrojtjes.

35. Forcat e Armatosura përbëhen nga tre shërbime: Forcat Tokësore, Forcat Detare dhe Forcat Ajrore, si dhe formacionet mbështetëse.

Komandimi e drejtimi në Forcat e Armatosura





## FORCAT TOKËSORE

36. Misioni i Forcave Tokësore është të mbrojnë sovranitetin e integritetin territorial dhe rendin kushtetues të Republikës së Shqipërisë.

Për zbatimin e këtij misioni ato zbatojnë këto detyra :

- reagojnë menjëherë për çdo shkelje të tërësisë territoriale dhe, në bashkëveprim me forcat e kufirit, sigurojnë ushtrimin e sovranitetit në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- marrin pjesë në mbrojtjen e rendit kushtetues, siç përcaktohet me ligj;
- marrin pjesë në operacionet ndërkombëtare në kuadrin e forcave shumëkombëshe;
- sigurojnë praninë e përhershme në drejtimet e kërcënuara;

- mbrojnë kufijtë dhe territorin e vendit në bashkëveprim me forcat ajrore e detare dhe ato të kufirit të Ministrisë së Rëndit (këto të fundit mbajnë nën vëzhgim e kontroll kufirin shtetëror dhe hyrje daljet nëpërmjet tij).


- ndihmojnë popullsinë në rast fatkeqësish natyrore e industriale dhe e lajmërojnë atë për rreziqet me natyrë joluftarake ose luftarake.

Forcat Tokësore marrin pjesë në Programin e Partneritetit për Paqe, caktojnë forca për veprime e stërvitje të përbashkëta, planizojnë masa për të realizuar ndërveprimin me forcat e aleatëve të mundshëm.

37. Komandanti i Forcave Tokësore varet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe është eprori më i lartë i këtyre forcave. Ai ushtron komandimin e kontrollin ndaj : 6 brigadave të këmbësisë, 1 brigade të reagimit të shpejtë, Inspektoriatit të Forcave Territoriale me 15 regjimente territoriale, 1 brigade tankiste, 2 brigadave të artilerisë, 1 batalion zbulimi, 1 regjimenti të raketave dhe të artilerisë kundërajrore, 1 regjimenti të mbrojtjes nga armët e dëmtimit në masë dhe ndaj elementëve mbështetës të Forcave Tokësore.

Forcat Tokësore përbëhen nga tri kategori trupash : të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes. Në trupat e luftimit përfshihen : këmbësoria, këmbësoria e mekanizuar, tanket, komandot; në trupat e mbështetjes së luftimit përfshihen : zbulimi, artileria kundërajrore, artileria fushore, xhenjoja, komunikimi, policia ushtarake dhe mbrojtja nga armët e dëmtimit në masë; ndërsa në trupat e mbështetjes përfshihen : transporti, shëndetësia, municionet, personeli, riparimet e mirëmbajtja, intendenca, karburantet dhe shërbimet e tjera.

## Organizimi i Forcave Tokësore



## FORCAT AJRORE

38. Misioni i Forcave Ajrore është të ushtrojnë sovranitetin në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë e ta mbrojnë atë dhe të realizojnë mbrojtjen e objekteve të rëndësishme e mbështetjen e afërt me zjarr të veprimeve të forcave tokësore e detare.

Për realizimin e misionit të tyre, Forcat Ajrore plotësojnë këto detyra kryesore:


- vëzhgojnë hapësirën ajrore e lajmërojnë për kërcënimet; kontrollojnë fluturimet në hapësirën ajrore; parandalojnë dhe shmangin shkeljen e sovranitetit të Republikës së Shqipërisë në hapësirën ajrore;
- kryejnë operacione kërkim - shpëtimi dhe humanitare;
- mbrojnë me zjarr tokë - ajër objektet e rëndësishme strategjike dhe trupat;
- mbështetin me zjarr veprimet e forcave tokësore e detare;
- kryejnë transport ajror të kufizuar;
- në kushte të përshtatëshme zhvillojnë luftim në ajër.

39. Forcat Ajrore marrin pjesë në Programin e Partneritetit për Paqe, caktojnë forca për veprime e stërvitje të përbashkëta; planizojnë masa për të realizuar ndërveprimin me aeroplanët dhe aeroportet e aleatëve të mundshëm dhe për drejtimin e mbështetjen logjistike të aeroplanëve aleatë nga aeroportet shqiptare.

40. Komandanti i Forcave Ajrore varet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe është eprori më i lartë i këtyre forcave. Ai ushtron komandim - kontrollin ndaj Krahut Ajror të Gjuejtës-Bombarduesave, Regjimentit të Zbulimit Elektronik, Brigadës së Raketave dhe të Artilerisë Kundërajrore, Regjimentit të Transportit Ajror, Akademisë së Aviacionit dhe Shërbimit Meteorologjik.

41. Forcat Ajrore përbëhen nga trupat e luftimit (aeroplanët luftarake, raketat tokë - ajër dhe artileria kundërajrore), trupat e mbështetjes së luftimit (zbulim-lajmërimi për rreziqet ajrore, këmbësoria dhe artileria kundërajrore e mbrojtjes së aeroporteve, shërbimi hidrografik, zbulimi e komunikimi) dhe trupat e mbështetjes logjistike (aeroplanët e transportit, karburantet, intendenca, municionet, riparimet e mirëmbajtja).

## Organizimi i Forcave Ajrore



Forca: kohe paqe 3500  
kohe lufte 9.266

## FORCAT DETARE

së, të mbrojnë atë në bashkëveprim me forcat tokësore e ajrore dhe të ushtrojnë ligjshmërinë në det.

Për zbatimin e këtij misioni ato zbatojnë këto detyra kryesore :

- mbrojnë detin territorial dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operacione të përbashkëta me forcat tokësore e ajrore;


- parandalojnë orvatjet për të kufizuar lirinë e lundrimit dhe veprimtaritë në hapësirën detare shqiptare, vëzhgojnë dhe kontrollojnë lëvizjet në det, parandalojnë dhe shmangin shkeljen e sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, ruajnë dhe mbrojnë mjedisin detar, ushtrojnë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave e të njerëzve;

- sigurojnë jetën në det dhe realizojnë operacionet e kërkim-shpëtimit, përgatisin dhe pajisin me dokumentacionin e nevojshëm hidro-lundrimor të gjitha mjetet lundruese me flamur shqiptar, pajisin bregdetin shqiptar me mjetet e nevojshme për lundrim të parrezikshëm.

43. Forcat Detare marrin pjesë në Programin e Partneritetit për Paqe, planizojnë masa për të realizuar ndërveprimin me anijet e aleatëve të mundshëm dhe për mbështetjen logjistike të këtyre anijeve.

44. Komandanti i Forcave Detare varet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe është eprori më i lartë i këtyre forcave. Ai ushtron komandim - kontrollin ndaj dy distrikteve detare, shërbimit hidrografik, Kantierit të Riparimit të Anijeve dhe Akademisë së Detarisë.

45. Forcat Detare përbëhen nga trupat e luftimit (anijet mbiujse luftarake), trupat e mbështetjes së luftimit (artileria bregdetare, artileria kundërajrore, shërbimi hidrografik, zbulimi e komunikimi) dhe trupat e mbështetjes logjistike (anijet e transportit, karburantet, intendenca, municionet, riparimet e mirëmbajtja).



Kompania e shtabit

Forca: Kohë paqeje 2462

Kohë lufte 3500

#### KLASIFIKIMI I FORCAVE DHE DETYRAT E TYRE

46. Forcat e Armatosura kategorizohen në Forca të Reagimit të Shpejtë, Forca Kryesore të

Mbrojtjes dhe Forca Territoriale.

47. Forcat e Reagimit të Shpejtë kanë si mision frenimin (shkurajimin) e agresorëve potencialë në nisjen e armiqësive ndaj Republikës së Shqipërisë dhe pjesëmarrjen në operacionet e mbështetjes së paqes.

Ato përbëhen nga Brigada e Reagimit të Shpejtë, Regjimenti i Transportit Ajror, 1 skuadron i aeroplanëve të luftimit dhe 1 grup anijesh luftarake.

48. Forcat Kryesore të Mbrojtjes kanë si mision përgatitjen e gatishmërinë në kohë paqeje, rritjen e forcës nëpërmjet mobilizimit të rezervistëve dhe mbrojtjen e vendit bazuar në kapacitetet e veta dhe mundësisht me aleatë.

49. Forcat Territoriale kanë si mision përgatitjen në kohë paqeje, mobilizimin në rast krize ose luftë dhe mbrojtjen e rajonit ose zonës që kanë në përgjegjësi.

## KOMANDAT MBËSHTETËSE

50. Për të mbështetur Forcat e Armatosura në kryerjen e misionit të tyre, krijohen Komanda e Logjistikës dhe Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes, si dhe Inspektorati i Forcave Territoriale.

51. Komandanti i Logjistikës varet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe përgjigjet për operacionet e mbështetjes logjistike të Forcave të Armatosura.

52. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes varet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe përgjigjet për: hartimin e doktrinës ushtarake në të gjitha nivelet (operative e taktike) dhe për të tre shërbimet; studimet e analizat strategjike; hartimin e programeve të përgatitjes së shkollave dhe të trupave; studimet për zhvillimin e shërbimeve dhe të elementeve përbërëse të tyre; studime në fushën e lidërshit dhe të drejtimit të brendshëm dhe procesin akademik në shkollat ushtarake.

Nga komandanti i Doktrinës dhe stërvitjes varen: Akademia e Mbrojtjes, Akademia Ushtarake "Skënderbej", Akademia e Nënoficerëve dhe për anën akademiko - mësimore e të doktrinës edhe akademitë e forcave ajrore e detare dhe të gjitha shkollat bazë të trupave.

53. Inspektorati i Forcave Territoriale varet nga Komandanti i Forcave Tokësore dhe përgjigjet për organizimin, përgatitjen, stërvitjen, planizimin dhe drejtimin e Forcave Territoriale.

## POLICIA USHTARAKE

54. Misioni i Policisë Ushtarake është zbatimi i rendit ushtarak në Forcat e Armatosura dhe ndihmesa, siç përcaktohet me ligj, në mbrojtjen e rendit kushtetues.

Për zbatimin e këtij misioni Policia Ushtarake kryen këto detyra:

- merr pjesë në mbrojtjen e pronës dhe të objekteve ushtarake në përdorim të Forcave të Armatosura dhe asnjëherë veprimet kriminale ndaj tyre;
- ushtron zbatimin e rendit ushtarak;
- mbron institucionet e objektet shtetërore të rëndësisë së veçantë dhe lufton terrorizmin, siç përcaktohet me ligj të veçantë.

## RIORGANIZIMI I MINISTRISË SË MBROJTJES

55. Pjesë e ristrukturimit të forcave do të jetë edhe riorganizimi i Ministrisë së Mbrojtjes. Ai do të bëhet në bazë të këtyre kritereve: sigurimi i drejtimit civil, rritja e efektivitetit të punës, shmangia e dublikimeve, pakësimi i hallkave të drejtimit dhe përmirësimi i bashkëpunimit midis drejtorive e degëve, konceptimi i Shtabit të Përgjithshëm si pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe si komandë e përbashkët për drejtimin operacional të trupave, futja e sistemit të "kontrollit e të balancës" midis prokurimit, kontroll-revizionit dhe financës, organizimi i Shtabit të Përgjithshëm sipas përvojës së tanishme të vendeve të NATO-s, realizimi i komandës unike, përafrimi me strukturat e organizmave të tilla në vendet e NATO-s dhe lirimi i Ministrit të Mbrojtjes dhe i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nga punët rutinë, për t'u marrë me çështjet më të mëdha të mbrojtjes.



#### IV. PLANIFIKIMI I FORCËS DHE I BURIMEVE

56. Planifikimi i mbrojtjes do të sigurojë baraspeshën midis kërcënimeve e rreziqeve dhe burimeve të vendit që duhen vënë në dispozicion për Forcat e Armatosura dhe mbrojtjen.

Realizimi i kësaj baraspeshë të arrihet nëpërmjet Sistemit të Planifikimit, të Programimit dhe të Buxhetimit. Planifikimi është procesi i përcaktimit të strategjisë ushtarake, të objektivave strategjike dhe të strukturës së forcave për një periudhë 10-vjeçare. Programimi është procesi i zbatimit të objektivave strategjike në një periudhë kohe të caktuar (çdo vit të 10 - vjeçarit), të mbështetura me burime financiare. Buxhetimi është shpërndarja e burimeve financiare në përshtatje me programin (bëhet vjetor).

#### PERSONELI

57. Personeli aktiv i Forcave të Armatosura në kohë paqeje do të jetë 31.000 veta: 4000 oficerë, 4500 nënoficerë, 2500 punonjës civilë, 19.000 ushtarë dhe 1000 studentë ushtarakë dhe rezervistë në stërvitje.

Ndërsa në kohë lufte personel i Forcave të Armatosura do të jetë 120.000 vetë.

58. Politikat me personelin do të jenë të hapura e të zbatueshme dhe do të kenë si objekt zgjedhjen e burimeve njerëzore, plotësimin e formacioneve ushtarake, arsimimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të tyre, avancimin në detyrë dhe gradimet, trajtimin e kujdesin për personelin ushtarak e civil, mbajtjen e dokumentacionit dhe daljen në rezervë e në pension.

59. Politika me personelin të sigurojë ndërtimin e një force profesionale moderne, e aftë të përballojë sfidat teknologjike e të sigurimit të shekullit të 21-të. Do të ketë mundësi punësimi të barabarta për meshkujt e femrat, do të vijë duke u rritur përbërësi profesional, do thithet më shumë inteligjencia duke u dhënë oficerëve arsimin e lartë universitar, dhe do të punësohen civilë në Ministrinë e Mbrojtjes, në Shtabin e Përgjithshëm dhe në shërbime të ndryshme.

60. Plotësimi dhe përmirësimi i bazës ligjore për trajtimin, emërimet, gradimet, strehimin, statusin, shëndetin, shlodhjen, arsimimin dhe pensionimin e ushtarakëve, shihen si një nga objektivat kryesorë të politikës së mbrojtjes. Mbështetur në përvojat e ushtrive të tjera të NATO-s, të njësohet grada me vendin e punës e pagën dhe të rishikohen ligjet e rregullat e tanishme, për të ndërtuar një hierarki ushtarake moderne dhe efektive. Gjithashtu të caktohen afate shërbimi 2-5 vjet për çdo vend pune që i jepet oficerit aktiv.

61. Personeli i Forcave të Armatosura do të ketë status të veçantë të miratuar nga Kuvendi; do të paguhet më shumë për punë të krahaseshme se sa sektori publik (shtetëror); do të sigurohet për efekt pensioni dhe paaftësie; do të ketë strehim nga shteti atje ku shërben; do të përfitojë kujdes shëndetësor falas për të dhe familjen dhe do të gëzojë të drejtën për leje të paguar e të drejtën për të pushaur në shtëpitë e pushimit (duke i siguruar strehimin falas).

62. Oficerët, nënoficerët dhe ushtarët profesionistë që pranojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura duhet të nënshkruajnë një kontratë në çastin e hyrjes, ku të përcaktohen afatet e shërbimit dhe detyrimet e tjera të ndërsjella.

63. Shërbimi mjekësor, në kohë paqeje, të mbajë në gjëndje të mirë fizike e shpirtërore personelin ushtarak dhe të përmirësojë mjedisin ku shërben e stërvitet ai. Ndërsa në kohë lufte të sigurojë një sistem efikas të evakuimit dhe trajtimit mjekësor të personelit të dëmtuar.

64. Plotësimi me ushtarë aktivë do të bëhet duke kombinuar shërbimin e detyrueshëm ushtarak me atë vullnetar (profesionist, me ushtarë rrogetarë). Rritja e kontigjentit vullnetar-profesionist do të bëhet shkallë-shkallë, në varësi nga burimet financiare dhe do të arrijë në 50 përqind të numrit të përgjithshëm në fund të 5-vjeçarit të parë.

#### REZERVISTËT

65. Plotësimi i forcave, në të tre shërbimet, për kohë lufte arrihet me mobilizimin e rezervistëve.

Gjatë kohës së paqes ata mbahen në evidencë dhe përgatiten e thirren në stërvitje. Komandat ushtarake mbajnë pajisjet e armatimet për rezervistë dhe organizojnë, në bashkëpunim me pushtetin vendor, sistemin e lajmërimit e të thirrjes në armë.

66. Pjesëmarrja e rezervistëve në mbrojtjen e vendit shihet si shprehje e vullnetit të popullit për vetëmbrojtje.

67. Për marrjen në evidencë të rezervistëve dhe thirrjen e tyre në stërvitje dhe veprimtari të tjera, mbahet parasysh: ruatja e specialitetit të fituar gjatë shërbimit ushtarak; marrja në evidencë menjëherë pas lirimit; njoftimi 1 vit përpara për thirrjet në stërvitjet rutinë; dhe kohëzgjatja e thirrjes në stërvitje të jetë 4-7 ditë në vit.

Përbërësi rezervë do të klasifikohet në tri kategori kryesore: rezervë e gatshme, rezervë kryesore dhe rezervë plotësuese ose mbështetëse.

## PËRGATITJA E PERSONELIT

68. Përgatitja do të jetë detyra parësore e Forcave të Armatosura në periudhë paqeje. Ajo përfshin marrjen e njohurive teorike-praktike në artin e luftës nga personeli ushtarak. Nëpërmjet përgatitjes do të rritet profesionalizmi ushtarak, duke realizuar të njëjtat standarde që realizohen në ushtritë e tjera.

69. Në vitet 2000-2004 të rritet numri i pranimeve në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" dhe në Akademinë e Nënoficerëve, në përshtatje me sasinë e oficerëve të rinj dhe të nënoficerëve që duhen për të plotësuar strukturën e re dhe me grafikun e ndërtimit të Forcave të Armatosura.

70. Struktura e re e Forcave të Armatosura do të krijojë kushte për përgatitjen e të gjithë ushtarëve që thirren për shërbim në Forcat e Armatosura. Gjithashtu do të përgatiten nënoficerët në një rol të ri, atë të drejtuesit ushtarak në nivelet më të ulta të komandimit, sipas përvojave më të mira të ushtrive perëndimore.

Përveç kësaj do të krijohen edhe infrastrukturat e nevojshme, qendra e poligone stërvitore në shkallë kombëtare.

71. Akademia e Mbrojtjes, Akademia Ushtarake "Skënderbej", Akademia e Nënoficerëve, akademitë e tjera dhe shkollat bazë të specialiteteve do të sigurojnë përgatitjen dhe arsimimin e drejtuesave ushtarakë për të gjitha shërbimet dhe për të gjitha nivelet e drejtimit.

Shkollat ushtarake do të zbatojnë lirinë akademike. Filozofia e të mësuarit në shkolla do të jetë t'u mësojnë studentëve "si të mendojnë" dhe jo "çfarë të mendojnë".

Arsimimi dhe përgatitja për oficerët e karrierës do të bëhen të shkallëzuara për çdo nivel drejtimi, të lidhura me mundësitë reale që kanë individët për të përparuar në karrierën ushtarake dhe politikat e avancimit të oficerëve dhe nënoficerëve.


72. Bazë e përgatitjes së nënoficerëve dhe oficerëve të rinj do të jenë shkollat tona ushtarake. Kualifikimi i tyre i mëtejshëm do të bëhet kryesisht në shkollat tona ushtarake, por do të shfrytëzohen edhe programet dypalëshe për kualifikime edhe në shkolla të huaja ushtarake për të njohur përvojat e të tjerëve.

## BUXHETI I MBROJTJES

73. Politika e Mbrojtjes do të mbështesë Forcat e Armatosura me burimet e nevojshme financiare për kryerjen e misionit dhe për zhvillimin e tyre.

74. Shpenzimet për mbrojtjen kanë vijuar nga 7.1 miliard lekë deri në vitin 1994, në 4.5 miliard lekë në vitin 1998. Në vitin 1998 shpenzimet e mbrojtjes zinin 3.6 për qind të buxhetit shtetëror ose 1.4 për qind të prodhimit të përgjithshëm të vendit. Për vitin 1999 buxheti është 5.7 miliard lekë. Rritja shkallë-shkallë e buxhetit të mbrojtjes do të mundësojë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të pagesave të ushtarakëve, do të përmirësojë infrastrukturën ushtarake e do t'i bëjë ato të ndërveprueshme për operacione të përbashkëta dhe do të modernizojë pajisjet luftarake të Forcave të Armatosura.

75. Buxheti i Mbrojtjes, 1994-1998



76. Objektivi është që në plan afatmesëm (5-vjeçari i ardhshëm) të investohet për kushtet e jetesës, pagat dhe për ringritjen e Forcave të Armatosura sipas strukturës së re, duke u përqendruar në formacionet luftarake që janë përcaktuar si parësore. Ndërsa në plan afatgjatë (2005-2009) do të mbështetet modernizimi i Forcave të Armatosura.

Përmirësimi i pagave të fillojë me një dyfishim të tyre në vitin 2000 dhe me një rritje shkallë-shkallë në vitet e tjera.

77. Mbështetur në objektivin e lartpërmendur do të tentohet që në fund të 5-vjeçarit të ardhshëm, në vitin 2004, buxheti i mbrojtjes të arrijë në 13 miliard lekë (me vlerën aktuale të lekut), të cilat do të përdoren për mbajtjen e Forcave të Armatosura dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

## KAPACITETET MBROJTËSE DHE MODERNIZIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA

78. Veç sa më lart Qeveria do të mbështesë edhe programe të veçanta për modernizimin e Forcave të Armatosura dhe përmirësimin e infrastrukturave ushtarake.

Përparësi në krijimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe në modernizimin e Forcave të Armatosura do të kenë: përmirësimi i kushteve të jetesës së trupave, përmirësimi i infrastrukturave ushtarake për t'i bërë të ndërveprueshme për forcat e NATO-s, zbulimi strategjik, operativ e taktik në forcat tokësore, ajrore e detare; sistemet e informacionit e të komunikimit; lëvizshmëria e trupave; rritja e thellësisë dhe e saktësisë së zjarrit, transporti me helikopterë; ndërtimi i qendrave dhe poligoneve të stërvitjes; mbrotja nga aviacioni e sulmet ajrore; ngritja e sistemit të vëzhgimit bregdetar; ngritja e sistemit të hapësirës ajrore dhe informatizimi i sistemit të drejtimit të Forcave të Armatosura dhe i procesit mësimor në shkollat ushtarake.

79. Industria jonë ushtarake do të mbështesë Forcat tona të Armatosura me prodhimin e armëve të vogla për këmbësorinë, municionet për to dhe lëndët plasëse. Ajo do të konkurrojë në tregun e brendshëm e të jashtëm, do të fusë teknologji të reja, do të rinovohet dhe do të prodhojë edhe për tregun civil.

80. Buxheti i mbrojtjes do të ndikojë në mënyrë vendimtare procesin 10-vjeçar të ristrukturimit të Forcave të Armatosura. Struktura e re e forcave do të ruhet si model dhe zbatimi i saj në kohë do të shkojë në varësi nga burimet financiare. Pavarërisht nga kjo, formacionet që përbëjnë zemrën e Forcave të Armatosura si: komandat e forcave tokësore, ajrore e detare; komandat e logjistikës e të doktrinës; Brigada Komando, Brigada e Reagimit të Shpejtë; 2 brigada këmbësorie, Regjimenti i Policisë Ushtarake, Brigada e Tankeve, 1 brigadë artilerie, Brigada e Komunikimit, Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Brigada e Artilerisë Kundërajrore, Regjimenti i Kimisë dhe batalioni i vendkomandës së Shtabit të Përgjithshëm, do të aktivizohen me çdo kusht.

## PLANIZIMI I ZBATIMIT TË STRUKTURËS SË RE

81. Ristrukturimi i Forcave të Armatosura vlerësohet si një proces. Realizimi i programeve do të mbështetet me burimet financiare dhe me përgatitjen e personelit, sidomos atij oficer dhe nënoficer.

82. Kalimi tërësisht në strukturën e re do të bëhet shkallë-shkallë sipas përparësive dhe parashikohet të realizohet për një periudhë 10 - vjeçare.

83. Gjatë vitit 2000 do të ristrukturohen ose organizohen: Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe komandat kryesore ushtarake (e Forcave Tokësore, Detare e Ajrore, e Logjistikës e Doktrinës e Stërvitjes).

84. Shtabi i Përgjithshëm, brenda vitit 2000 do të përcaktojë përhapjen përfundimtare të Forcave të Armatosura sipas strukturës së re, përfshirë infrastrukturën ushtarake (kazerma, parqe, tunele e objekte të fortifikuara, baza, vendbazime, porte, aeroporte, objekte fortifikimi, linja komunikimi, vendkomanda, poligonet etj.). Brenda kësaj kohe do të përcaktohen edhe sistemet e pajisjet dhe armatim-municionet që duhen për strukturën e re apo që do të ruhen dhe ato që mund të vihen në dispozicion të të tjerëve, që mund të shiten ose të asgjësohen.

85. Në periudhën 2000-2001 do të përqendrohet, konservohet dhe trajtohet teknika e rëndë luftarake që do të ruhen në rezervë, si dhe do të bëhen veprimet me pjesën tjetër të teknikës që do të dalë tepër për të tretët, për t'u shitur ose për t'u asgjësuar.

86. Gjatë viteve 2000 të përfundojnë të gjitha projektet për përmirësimin apo ndërtimin e infrastrukturave për nevojat e strukturës së re, përfshirë qendrat e stërvitjes e poligonet. Ndërsa në periudhën 2000-2004 të ndërtohet infrastruktura për njësitë që do t'u jepet përparësi, duke filluar me ato në Kukës e në Shkodër.

87. Gjatë periudhës 2000-2001 do të aktivizohen tërësisht akademitë ushtarake ekzistuese të të gjitha niveleve, si dhe do të fillojnë veprimtarinë shkollat e specialiteteve (këmbësori, zbulim, artileri, artileri e raketa kundërajrore, tanke, logjistikë, transport, kimi, xhenio e ndërlidhje).

88. Plotësimi me personel do të realizohet shkallë-shkallë në përputhje me planet për ndërtimin e

infrastrukturave e për përmirësimin e kushteve të jetesës, të përgatitjes së personelit oficer e nënoficer dhe me planet financiare. Në vitin 2000 personeli i Forcave të Armatosura do të jetë 20.000 veta, në vitin 2001-22 000 veta, në vitin 2002-24 000 veta, në vitin 2003 - 26 000 veta, ndërsa në vitin 2005 - 31 000 veta.

89. Ristrukturimi i formacioneve ushtarake do të bëhet sipas këtyre përparësive:

- Përparësi e parë përcaktohen: Sistemi i vrojtimit dhe i zbulimit tokësor, ajror e detar, brigadat e këmbësonisë në Kukës e Shkodër; Brigada "Komando" në Tiranë, përfshirë batalionin special komando; Brigada e Reagimit të Shpejtë në Tiranë; Regjimenti i Mbrojtjes Civile në Tiranë; Regjimenti i policisë Ushtarake, Batalioni i vendkomandës së Shtabit të Përgjithshëm, Regjimenti i Transportit Ajror, Spitali Qendror i Ushtrisë dhe akademitë ushtarake.

- Përparësi e dytë përcaktohen: Brigada e Komunikimit, Brigada e Transportit në Tiranë, Brigada e Artilerisë në Shkodër, Distrikti Detar në Durrës dhe Brigada e Transportit në Tiranë.

- Përparësi e tretë përcaktohen: Brigada e Tankeve në Tiranë, Brigada e Artilerisë në Tiranë, Krahu Ajror i Luftimit, Brigada e Xhenios në Tiranë, Distrikti Detar në Vlorë, Regjimenti i Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë në Tiranë dhe formacionet e tjera.

90. Përmirësimi i sistemit të drejtimit të Forcave të Armatosura nëpërmjet përmirësimit të procedurave, decentralizimit të kompetencave dhe administrimit do të jetë një detyrë e rëndësishme në vitet 1999-2000.

## PËRFUNDIME

Zbatimi i Politikës së Mbrojtjes do të fuqizojë sigurinë dhe mbrojtjen dhe do t'i bëjë Forcat e Armatosura një instrument të fuqishëm për rritjen e autoritetit të shtetit tonë demokratik, si brenda ashtu edhe jashtë. Kjo do t'i krijojë mundësi shtetit tonë të ndikojë në forcimin e stabilitetit të brendshëm dhe atij rajonal.

Dokumenti i politikës së mbrojtjes është plan dhe program për ristrukturimin e ringritjen e Forcave të Armatosura, si dhe për modernizimin dhe zgjidhjen e problemeve aktuale në këto forca.

Zbatimi i politikës së mbrojtjes dhe ndërtimi i Forcave të Armatosura shihen si një domosdoshmëri në rrugën e ngritjes dhe të konsolidimit të institucioneve shtetërore në Shqipëri dhe për integrimin në strukturat euroatlantike të sigurimit. Kjo do të shikohet si një nga përparësitë kryesore të shtetit dhe të publikut tonë në vitet e ardhshme, për të garantuar mbijetesën në shekullin e ri.

**LIGJ**

**Nr.8572, datë 27.1.2000**

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË STRATEGJISË SË SIGURIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 12, 78, 83 pika 1, 168 e 169 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Strategjia e Sigurimit të Republikës së Shqipërisë synon përdorimin e të gjitha elementeve të fuqisë kombëtare për mbrojtjen dhe çuarjen përpara të interesave kombëtarë.

Zbatimi i strategjisë së sigurimit është përgjegjësi e të gjitha institucioneve qendrore e vendore.

Neni 2

Miratohet Dokumenti i Strategjisë së Sigurimit Kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përgatisë projektligjet e nevojshme, sipas parashikimeve dhe afateve të vendosura në strategjinë e sigurimit dhe të miratojë aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij dokumenti.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Skënder Gjinushi**

STRATEGJIA E SIGURIMIT  
TË REPUBLIKES SË SHQIPËRISË

# P Ë R M B A J T J A

|                                                                                           |    | Faqe |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|----|------|
| PJESA E PARË                                                                              |    |      |
| KUADRI STRATEGJIK I SIGURIMIT.....                                                        |    |      |
| 1                                                                                         |    |      |
| I. Mjedisi i sigurimit.....                                                               | 1  |      |
| II. Kërcënimet dhe rreziqet për sigurinë.....                                             | 2  |      |
| III. Interesat kombëtarë.....                                                             | 4  |      |
| IV. Perspektiva e sigurimit.....                                                          |    | 5    |
| PJESA E DYTË                                                                              |    |      |
| STRATEGJIA E SIGURIMIT.....                                                               |    |      |
| 6                                                                                         |    |      |
| V. Misioni i sigurimit.....                                                               | 6  |      |
| VI. Parimet e sigurimit.....                                                              | 6  |      |
| VII. Koncepti strategjik i sigurimit.....                                                 |    | 7    |
| VIII. Objektivat e sigurimit.....                                                         | 8  |      |
| PJESA E TRETË                                                                             |    |      |
| DREJTIMET KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË ELEMEN-<br>TEVE PËRBËRËSE TË STRATEGJISË SË SIGURIMIT |    | 10   |
| IX. Diplomacia.....                                                                       | 10 |      |
| X. Mbrojtja e rendit publik .....                                                         | 11 |      |
| XI. Politika ekonomko-financiare.....                                                     |    | 12   |
| XII. Mbrojtja civile.....                                                                 |    | 13   |
| XIII. Mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit.....                                            |    | 13   |
| XIV. Marrëdhëniet me opinionin publik.....                                                |    | 13   |
| XV. Politika e mbrojtjes .....                                                            | 14 |      |
| PJESA E KATËRT                                                                            |    |      |
| UDHËHEQJA STRATEGJIKE E SIGURIMIT.....                                                    |    | 15   |
| Bazat kushtetues të udhëheqjes strategjike të sigurimit...                                |    | 15   |
| Përgjegjësitë kushtetuese të udhëheqjes strategjike të sigurimit...                       | 16 |      |
| XVIII. Udhëheqja vendore e sigurimit.....                                                 |    | 17   |
| PËRFUNDIME.....                                                                           | 17 |      |

## PJESA E PARË KUADRI STRATEGJIK I SIGURIMIT

### I. MJEDISI I SIGURIMIT

1. Zhvillimet botërore e rajonale gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit XX sollën një epokë të re në mjedisin strategjik ndërkombëtar të sigurimit. Blloqet antagoniste dhe linja e konfrontimit ndërmjet tyre, praktikisht nuk ekzistojnë më. Pas rënies së këtij bipolariteti, në botë dhe veçanërisht në Europë, ne jemi dëshmitarë të zhvillimeve politike e ushtarake, të cilat nuk mund të parashikoheshin më parë. Komuniteti ndërkombëtar dhe sidomos ai europian po përballen me sfida të reja. Qysh me përfundimin e luftës së ftohtë, Europa karakterizohet nga konflikte të armatosura dhe akoma nuk është një ishull paqeje e stabiliteti të qëndrueshëm. Ajo, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi dhe indirekt, është e konfrontuar me qendrat e destabilizuara afër dhe larg saj, në veçanti me Ballkanin, vende të Europës Lindore, Irlandën e Veriut, Rajonin e Mesdheut, Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore.

2. Komuniteti demokratik ndërkombëtar ka intensifikuar veprimtarinë për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Pavarësisht nga pasiguritë dhe situatat e paqëndrueshme në rajone të veçanta, institucionet ndërkombëtare, fqinjët dhe partnerët tanë kërkojnë të parandalojnë konfliktet sidomos me përpjekje të vijueshme politike, diplomatike, ekonomike dhe me krijimin e strukturave të reja civile e ushtarake. Përfshirja e shteteve të Europës Qendrore e Lindore në institucionet ndërkombëtare, nxitja dhe krijimi i nismave rajonale, proceset e partneritetit dhe të programeve të inkurajimit të demokracive të reja mbi bazën e bashkëpunimit, dialogut e transparencës, janë tregues kuptimplotë drejt një mjedisi të ri sigurimi.

3. Zhvillimet demokratike në vendet e Europës Qendrore e Lindore tashmë janë një realitet. Ndërtimi i shoqërive të reja demokratike është synuar të arrihet nëpërmjet proceseve e reformave institucionale, politike, sociale e ekonomike. Cilësia, shpejtësia dhe arritjet për kapërcimin e periudhës së tranzicionit janë përcaktuar kryesisht nga gjendjet e sigurisë, trashëgimia dhe efektiviteti i reformave të kryera. Ndërkohë, gjatë këtyre proceseve, Europa Perëndimore është përballur me fenomene të tilla si emigracioni masiv drejt perëndimit, trafiku i paligjshëm dhe fenomenet e krimit, të cilat kanë marrë karakter shqetësues.

4. Në kontekstin Europian, Ballkani vazhdon të mbetet një rajon krizash e konfliktesh. Zhvillimet historike kanë qenë të tilla, që kanë lënë pasojë që edhe sot shkaktojnë destabilizim të Ballkanit. Të tilla janë përzjerja e kulturave dhe bashkësive fetare, prapambetja e theksuar në zhvillimin ekonomik, kulturor e demokratik, ndarjet etnike, fetare, kulturore e gjuhësore dhe formimi i psikologjisë së dhunës e konfliktit.

Vatrat kryesore të krizës e të konfliktit në rajonin e Ballkanit janë të lidhura kryesisht me politikën shoviniste serbe, e cila kërkon të realizojë me çdo kusht ëndrrën e keqe shekullore të Serbisë së Madhe. Aktualisht ekzistojnë tri vatra të nxehta konflikti në rajon:

4.1. Bosnjë-Hercegovina, ku u zhvillua një nga tragjeditë e përgjakshme në rajon.

4.2. Kosova, ku serbët shkaktuan një konflikt tjetër të armatosur dhe një krizë njerëzore me përmasa të mëdha. Tani zgjidhja e krizës kosovare mbi bazën e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, hap perspektiva për një rregullim të besueshëm dhe afatgjatë të krizës. Normalizimi gradual i situatës nëpërmjet zbatimit të vetëqeverisjes së zgjeruar si status kalimtar i Kosovës dhe afirmimi i bashkëjetesës shumetnike nën autoritetin ushtarak dhe civil ndërkombëtar, janë kushtet themelore për zgjidhjen paqësore të konfliktit.

5. Synimi i qartë për një Europë të pandarë e demokratike është një vizion dhe shans i ri për vendet e Europës Juglindore në kapërcimin e sfidave të sigurimit rajonal dhe për t'u integruar në familjen europiane. Pakti i Stabilitetit përfaqëson një projekt konkret dhe unik në këtë proces të vështirë. Zbatimi i shpejtë dhe efektiv i tij, kërkon një mentalitet të ri bashkëpunimi dhe bashkëjetese midis vendeve të Europës Juglindore, në frymën e njohjes dhe respektimit të interesave të secilit vend. Pakti i Stabilitetit synon shkapëputjen e Europës Juglindore nga e kaluara, mbi bazën e parimeve demokratike për zgjidhjen e konflikteve dhe ringjalljen e gjithanshme të rajonit.

6. Shqipëria po ndërmerr hapa progresive për të dalë nga gjendja e vështirë ekzistuese dhe po bën përpjekje për ndërtimin e një shteti modern demokratik. Në fillim të viteve '90-të, Shqipëria u përfshi në lëvizjen për përmbysjen e sistemit totalitar. Vendosija e sistemit demokratik në vitin 1991 solli në mënyrë të natyrshme pluralizmin partiak, ekonominë e tregut, nismën e lirë dhe hapjen e Shqipërisë me botën. Vijimësia e situatave të vështira si: përballimi i pasojave të sistemit totalitar komunist, ato të periudhave



të fillimit të viteve '90-të, pasojat e krizës totale të vitit 1997, konflikti dhe kriza humanitare e viteve 1998-1999 në Kosovë dhe ngjarjet e mesit të shtatorit të vitit 1998, e vendosën Shqipërinë në një gjendje të vështirë e të ekspozuar ndaj rreziqeve për paqen, sigurinë, sovranitetin e stabilitetin e saj.

## II. KËRCËNIMET DHE RREZIQET PËR SIGURINË

7. Tipar i gjendjeve të sigurisë për vende në tranzicion është jo vetëm prania e rreziqeve, por veçanërisht e kërcënimeve. Për vendin tonë ato janë shumë të dukshme. Shkaqet kryesore të shfaqjes së tyre janë të lidhura me realitetin e mjedisit të brendshëm dhe atë rajonal.

Situta e zhvillimeve gjeopolitike dhe gjeoekonomike nxjerrin në pah një seri kërcënimesh e rreziqesh për interesat dhe sigurimin tonë. Ato karakterizohen nga kompleksiteti, natyrat e ndryshme dhe vështirësia e parashikimit. Mjedisi i sotëm dhe i ardhshëm strategjik do të përfshijë një spektër të gjerë, të ndryshëm dhe të mpleksur të kërcënimeve e të rreziqeve të jashtme me ato të brendshme. Me gjithë vështirësitë e përcaktimit të një vije të qartë ndarjeje, ato mund të klasifikohen në kërcënime e rreziqe me natyrë të jashtme dhe të brendshme.

8. Kërcënimet dhe rreziqet e jashtme vënë në rrezik sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të Republikës së Shqipërisë, si rezultat i përdorimit të forcës ushtarake ose formave të tjera që synojnë të njëjtat qëllime.

8.1. Një rast tipik i kërcënimit në rajonin tonë është nacionalizmi. Shembull tipik i një kërcënimi të tillë dhe real është politika e regjimit në pushtet në ish-Jugosllavi gjatë luftës në Kosovë, që u lidh me inspirimin e sulmeve ndaj Shqipërisë, në formën e kërcënimeve, provokacioneve sistematike ushtarake dhe dhunimit të territorit dhe hapësirës ajrore. Kjo përforcohet edhe nga faktet që ky regjim vazhdon të mbetet një element aktiv i luftës, nacionalizmit dhe pretendimeve territoriale dhe një shtet që vë në dispozicion të ideologjisë nacionaliste arsenalin e armëve. Ndërkohë, ish-Jugosllavia është ende i vetmi shtet në rajon i papërfshirë në ndryshimet demokratike dhe integruese europiane.

8.2 Kërcënimi dhe rreziku i jashtëm ndaj sigurisë së vendit tonë mund të vijë edhe si rezultat i një destabilizimi të rajonit, nëpërmjet ringjalljes dhe dëshirës për realizimin e ndjenjave nacionaliste dhe zhvillimit të konflikteve etnike. Ky rast bëhet edhe më i pranueshëm po të mbahen parasysh gjendja e trashëguar konfliktuale në Ballkan, ekzistenca e një numri të konsiderueshëm nacionalitetesh brenda të njëjtit shtet, tendencat për krijimin e shteteve-kombe, niveli i ulët i respektimit të të drejtave të njeriut dhe i zhvillimit ekonomik.

9. Kërcënimet dhe rreziqet e brendshme, aktualisht përbëjnë një kompleksitet për nga natyra e tyre dhe që vështirësojnë në mënyrë të dukshme funksionimin normal të sigurisë së vendit.

9.1 Destabiliteti politik është një rrezik për sigurinë e vendit dhe ruajtjen e interesave kombëtare. Përvoja e deritanishme e demokracisë në Shqipëri tregon se destabiliteti politik ka qenë vijimisht i pranishëm në mjedisin e brendshëm. Ky fenomen ka çuar në mosfunksionimin e mirë të institucioneve demokratike, në mungesën e paqes sociale e të qetësisë publike, në mosarritjen e konsensusit politik dhe për çështje shumë të rëndësishme të vendit edhe në një venitje të prestigjit të Shqipërisë në kuadrin ndërkombëtar. Arritja e stabilitetit politik është një çështje jetike për shoqërinë shqiptare.

9.2 Zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik dhe kushtet e vështira ekonomiko-sociale në vend krijojnë situata të paqëndrueshme për sigurimin dhe jetën e njerëzve. Kalimi në demokraci dhe në ekonominë e tregut kërkon kryerjen e reformave të plota ekonomike. Krizat ekonomiko-financiare, kontrabanda dhe korrupsioni kanë sjellë pengimin e reformave, kryerjen keq të tyre, mungesën e rritjes së nivelit të jetesës dhe stimulimin e papunësisë. Papunësia dhe kushtet e vështira ekonomiko-sociale të mpleksuara me praninë në duart e njerëzve të një sasi të konsiderueshme armësh e municionesh kanë favorizuar kriminalitetin, kontrabandën e trafiket e ndryshme etj.

9.3 Krimi i organizuar ka mundur të bëhet i rrezikshëm për shoqërinë shqiptare. Aktualisht ekzistojnë rrjete e grupe kriminale të fuqishme me lidhje të brendshme e të jashtme që zhvillojnë trafik armësh, droge, njerëzish e deri tek korrupsioni dhe pastrimi i parave. Krimi i organizuar po shkon drejt profesionalizmit; ai është i armatosur dhe i predispozuar për akte dhune dhe bën presion për të influencuar në institucionet shtetërore. Shpërpjesëtimet aktuale ndërmjet instrumenteve të pamjaftueshme për të

zbuluar e luftuar krimin, pafuqisë juridike për ta ndëshkuar dhe përmasave e tendencave që ka zhvillimi i krimit, përbëjnë rrezik real për sot dhe për të ardhmen.

9.4 Terrorizmi është një mjet ekstrem i dhunës dhe një rrezik real për sigurinë tonë të brendshme. Pozita gjeostrategjike e Shqipërisë, gjendja e brendshme e stabilitetit të saj dhe ekzistenca e elementëve ekstremistë përbëjnë parakushte që ajo të shfrytëzohet si bazë logjistike, vepruese e ndërlikohet për grupet terroriste. Grupet militante dhe ekstreme, të cilat përdorin dhunën për të realizuar objektivat politikë, për të siguruar burime shtesë dhe për të detyruar politikanët të bëjnë koncensione, janë një rrezik serioz për sigurinë e jetës së qytetarëve dhe funksionimin e shtetit. Sot, terrorizmi është një rrezik ndërkombëtar dhe prania e tij ka marrë shtrirje të gjerë gjeografike.

9.5. Emigraconi masiv i qytetarëve shqiptarë drejt vendeve të tjera përbën një rrezik të madh për kombin shqiptar dhe zhvillimin e vendit. Fenomeni i emigrimeve masive e klandestine të qytetarëve shqiptarë drejt vendeve perëndimore paraqitet tashmë si një rrezik vital për Shqipërinë. Efektet e këtij fenomeni shprehen në humbjen e jetës së njerëzve, rrjedhjen e pakontrolluar të inteligjencies shqiptare, mplakjen artificiale të popullsisë, mungesën e dëshirës për të punuar dhe forcimin e ndjenjës së largimit nga vendlindja deri në përçmim, pasiguritë për jetën në emigracion, deformime e humbje të intelektit të tyre etj.

Parë në aspektin e sigurisë dhe të mbrojtjes problemet demografike paraqesin një shqetësim serioz. Aktualisht, ka një lëvizje të pakontrolluar të popullsisë kryesisht nga zonat veriore të vendit drejt kryeqytetit. Këto kanë krijuar shpërpjesëtime të konsiderueshme jo vetëm në aspektin e mbipopullimit, por edhe të largimit të njerëzve nga zona që, për sot dhe për të ardhmen, do të kenë nevojë për resurse njerëzore për plotësimin e strukturave të mbrojtjes së vendit.

9.6. Dizinformimi i opinionit publik është një instrument i rrezikshëm për destabilitetin e brendshëm. Informacionet e pasakta krijojnë në mënyrë të qëllimshme ose jo, situata pasigurie, frike e tensioni të panevojshëm dhe shpesh mund të çojnë në reagime publike dhe marrje vendimesh të padrejta.

9.7. Ndotja e mjedisit dhe sëmundjet me karakter masiv janë një rrezik me tendencë në rritje për jetën e njerëzve. Shkaqet për ndotjen e mjedisit janë të ndryshme si: industriale, të shkaktuara nga mbetjet dhe smogu i uzinave e mjeteve të transportit; teknologjike, të shkaktuara nga aksidentet teknologjike të armëve bërthamore, biologjike e kimike dhe shpërndarja e mbetjeve e materialeve toksike, si dhe me karaktere të ndryshme, të shkaktuara nga pakujdesitë e njerëzve, tregtimit të ushqimeve të pakontrolluara etj.

Përgjithësisht, shkaqet dhe rreziqet e ndotjes së mjedisit dhe të sëmundjeve masive janë me natyrë të brendshme dhe ndërkombëtare. Integrimi i masave për parandalimin, zbatimin e ligjshmërisë dhe formimi i edukatës qytetare janë të domosdoshme dhe kanë rëndësi jetike.

9.8. Mundësia e kthimit të një rreziku të brendshëm të armatosur në kërcënim të drejtpërdrejtë për paqen e stabilitetin e vendit dhe për të shkatërruar institucionet demokratike të shtetit. Realiteti shqiptar mbart shkaqe që mundësojnë zhvillimin e këtij rreziku. Të tilla janë: përhapja masive e armëve jo vetëm në duart e popullsisë, por në sasira të mëdha në grupe njerëzish me rrezikshmëri shoqërore; prania e krimit dhe e grupeve kriminale me natyrë të ndryshme dhe e mundësisë së bashkëpunimit të tyre me organizata antishqiptare jashtë vendit; gjendja relativisht e pakontrolluar e agjenturave të huaja dhe e mundësisë së veprimit të tyre, si dhe mundësia e organizimit të kontigjenteve ekstremiste në grupe ose organizata antikushtetuese.

9.9. Kërcënimet dhe rreziqet natyrore mund të shkaktojnë katastrofa dhe fatkeqësi për njerëzit e shoqërinë. Ky rrezik ekziston përgjithmonë dhe është i paparashikuar. Fenomenet natyrore si tërmetet, përmbytjet, erërat e fuqishme, dëborat e madhe, zjarret masive nga temperaturat shumë të larta dhe fenomene të tjera me origjinë të tillë, sjellin pasoja të rënda e shpeshherë masive për jetën e njerëzve dhe të mirat materiale.

### III.INTERESAT KOMBËTARË

10. Përcaktimi i interesave kombëtarë është përcaktues për zhvillimin e sigurisë së vendit. Ato i japin legjitimitetin, besueshmërinë dhe përgjegjësinë pushtetit politik për të arritur zhvillimin demokratik

të shtetit në kuadrin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Shteti, si një sistem unik koherent e ndërvlerësish, ndërmjet pushtetit, shoqërisë civile e qytetarëve dhe si një realitet natyror e organik i të gjithë elementeve përbërëse, udhëhiqet në thelb nga përcaktimi dhe realizimi i interesave kombëtarë.

Pushteti politik e ka për detyrë sublimë përcaktimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kombëtarë. Ky angazhim duhet të shoqërohet me kërkimin dhe sigurimin e konsensusit të gjerë nëpërmjet debatit publik. Ndodh që çdo interes kombëtar, jo kur është fjala për interesat e mbijetesës, mund të mos jetë edhe interes i përbashkët ose në interes të të gjithëve. Në këtë kuptim, unanimiteti për përcaktimin dhe realizimin e interesave kombëtarë nuk është domosdoshmëri. Por pranimi dhe konsensusi është rregull që duhet zbatuar me konsekuencë në një sistem demokratik.

11. Interesat e mbijetesës si ushtrimi i sovranitetit, mbrojtja e pavarësisë dhe e integritetit territorial të vendit; mbrojtja e rendit kushtetues; mbrojtja e jetës së qytetarëve dhe e lirive e të drejtave themelore të njeriut; zhvillimi ekonomik, mbrojtja e pasurive dhe e vlerave përbëjnë bazën e sigurimit të Republikës së Shqipërisë.

Interesat kombëtarë dhe shtrirja kohore e realizimit të tyre kanë një lidhje organike thelbësore me gjendjet e sigurisë, qëllimit më të lartë që i shërbejnë dhe përcaktimit të afateve të realizimit të tyre. Pavarësisht nga kohëzgjatja, thelbin e realizimit të interesave kombëtarë e përbëjnë përgjegjshmëria, legjitimiteti dhe ndershmëria e pushtetit politik, për t'i shërbyer kombit e shtetit të vet. Kjo e zbut dhe e mënjanon kontradiktën që mund të ekzistojë ndërmjet kohës që ka një qeverisje dhe kohës që i duhet për të realizuar interesat kombëtarë.

12. Përcaktimi i interesave të tjera ndihmon në përzgjedhjen e zgjidhjeve strategjike për sigurimin e vendit në përputhje me rreziqet, nevojat dhe objektivat që duhen arritur. Interesa të tilla janë: arritja e stabilitetit të brendshëm, çarmatimi i popullsisë dhe grumbullimi i armëve, programimi i proceseve të integritetit në NATO e BE, nxitja dhe pjesëmarrja në zhvillimin e proceseve të stabilitetit rajonal, zhvillimi i marrëdhënieve bilaterale me shtetet fqinje dhe partnerët, zgjidhja e problemeve sociale e të mbrojtjes së mjedisit etj.

#### IV. PERSPEKTIVAT E SIGURIMIT

13. Në këtë fundshekull janë hedhur bazat dhe është zhvilluar një partneritet i ri e i gjerë dhe po synohet drejt një sistemi të ri sigurimi. Republika e Shqipërisë është tashmë një partner aktiv dhe i përfshirë në institucionet e nismat ndërkombëtare. Efektet e këtij partneriteti janë parë dukshëm në ndihmën për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe kapërcimin e krizave e gjendjeve të vështira që kanë qenë të pranishme vitet e fundit. Kjo prani dhe marrëdhëniet aktive me NATO-n, OSBE-në e BE-në kanë mundësuar lehtësimin e pasojave dhe kanë rritur sigurinë e Shqipërisë në gjendjet e vështira. Roli dhe efektiviteti i institucioneve ndërkombëtare, si një nevojë e mundësi e përbashkët drejt një arkitekture të re të sigurimit, është përvijuar me një bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh me vendet fqinje dhe ato partnere, si dhe me angazhimet konkrete në nismat rajonale, të konsaktuara në parimet themelore të Paktit të Stabilitetit dhe Kartës së Sigurimit Europian.

14. Stabiliteti e siguria nënkuptojnë parandalimin e krizave e të konflikteve në rajon dhe zgjidhjen e tyre me rrugë e mjete paqësore. Demokratizimi i Ballkanit, realizohet me kapërcimin e sfidave të tilla si konfliktet e natyrës etnike, fetare e shoqërore, të cilat kanë krijuar pasiguri dhe rreziqe për paqen, për krijimin e një paqeje të qëndrueshme nëpërmjet pajtimit politik dhe realizimit të ringjalljes ekonomike. Zhvillimi dhe përfshirja praktikisht në konceptet e sigurimit europian dhe rajonal mund të konsiderohen si mjeti më efektiv që do të përballojë kompleksitetin e realitetit të sotëm dhe të ardhshëm të rreziqeve e kërcënimeve për paqen dhe stabilitetin.

15. Konsolidimi në praktikë i konceptit se sigurimi i vendit fillon së brendshmi. Zhvillimi i proceseve të sigurimit kombëtar në kushtet e krijuara dhe për të ardhmen kërkon që shteti të vihet në shërbim të popullit dhe strukturat e shoqërisë civile të forcohen ndjeshëm. Vendosja e rendit publik nëpërmjet konsolidimit të fuqisë juridike dhe ekzekutive për të mbrojtur qytetarët, shoqërinë civile dhe shtetin do të përcaktojë suksesin e tranzicionit për në demokraci, reformat e ekonomisë së tregut, si dhe parandalimin e krizave të brendshme.

Mundësia e ndërtimit të instrumenteve të mjaftueshme të sigurisë.

Aktualisht Shqipëria ka një gjendje të pamjaftueshme të instrumenteve të sigurisë. Kjo ka vënë në rrezik jo vetëm mbrojtjen e jetës, pronës dhe pasurisë shqiptare, por edhe sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin e vendit. Republika e Shqipërisë i ka të gjitha potencialet njerëzore e materiale dhe vlerat e duhura morale e kulturore për t'i rikrijuar cilësisht dhe të efektshme instrumentet e sigurisë, për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat kombëtarë.

16. Zhvillimi ekonomik dhe rritja e nivelit të jetesës janë një faktor shumë i rëndësishëm stabiliteti dhe sigurie. Faktori ekonomik ka një ndikim shumë të madh në proceset e sigurimit kombëtar dhe në bashkëpunimin me tregjet rajonale, europiane e botërore. Shfrytëzimi i potencialeve ekonomike, zhvillimi teknologjik dhe infrastrukturor, për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për komunikim, do të mundësojë kthimin e Shqipërisë në një qendër të rëndësishme në lidhjet ndërmjet Ballkanit dhe Europës e vendeve të tjera mesdhetare. Nëpërmjet këtij zhvillimi Shqipëria do të mund të krijojë një rol shumë të rëndësishëm për paqen dhe sigurimin edhe në një kuadër më të gjerë.

## PJESA E DYTË STRATEGJIA E SIGURIMIT

### V. MISIONI I SIGURIMIT

17. Sigurimi i Republikës së Shqipërisë ka karakter kombëtar dhe bëhet publik. Ushtrimi i sovranitetit, mbrojtja e pavarësisë dhe tërësisë territoriale, mbrojtja e jetës dhe pronës, mbrojtja e dinjitetit dhe e çështjes kombëtare, zhvillimi i prosperitetit e i demokracisë, si dhe integrimi në strukturat ndërkombëtare të sigurimit kolektiv janë misionet bazë të sigurimit të Republikës së Shqipërisë.

Zhvillimi, përbashkimi dhe përdorimi i të gjitha elementeve të fuqisë kombëtare kryhet në përputhje me Kushtetutën e ligjet e Republikës së Shqipërisë, me interesat kombëtarë dhe respektimin e angazhimeve ndërkombëtare të detyrueshme.

### VI. PARIMET E SIGURIMIT

18.1. Respektimi dhe zbatimi me përgjegjësi i kuadrit ligjor shqiptar dhe atij ndërkombëtar në fushën e sigurimit. Sigurimi i Republikës së Shqipërisë mbështetet në Kushtetutën dhe ligjet e saj, të miratuara nga Kuvendi dhe në aktet ndërkombëtare, ku ajo është angazhuar. Legjislacioni dhe veprimtaria në fushën e sigurimit kombëtar është e përputhur me standardet konceptuale e parimore të një shteti demokratik, si dhe me ato të NATO-s e të BE-së.

18.2. Republika e Shqipërisë nuk shpreh armiqësi dhe pretendime territoriale për ndryshim kufijsh me përdorimin e forcës. Ajo synon të jetë një faktor stabiliteti e paqeje në rajon. Shqipëria është kundër krijimit të krizave e konflikteve rajonale dhe të zgjidhjes së tyre me mjetet e dhunës. Përparësore për sigurimin e Republikës së Shqipërisë janë ndërtimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve të sinqerta e të ndërsjella me fqinjët, si dhe mbrojtja e lirive dhe e të drejtave të shqiptarëve kudo që ndodhen.

18.3. Konsolidimi dhe zhvillimi i instrumenteve të sigurimit janë produkt i mbrojtjes së interesave kombëtarë dhe nuk cenojnë interesat apo sigurinë e vendeve të tjera. Ato janë shprehje e politikave të ruajtjes së sovranitetit e pavarësisë, lirisë dhe prosperitetit, të paqes dhe integritetit të një shteti demokratik, në mbrojtje të vetvetes dhe si një garanci për t'u bërë i besueshëm në kuadrin ndërkombëtar.

18.4 Mbrojtja dhe zhvillimi i identitetit dhe idealit kombëtar konsiderohen me rëndësi jetike për të sotmen dhe të ardhmen e kombit shqiptar. Propagandimi, edukimi dhe mbrojtja e vlerave historike, kulturore, morale e shpirtërore i japin jetë dinjitetit të kombit shqiptar. Shqipëria mbron dhe respekton me ligj të drejtat e njeriut, liritë fetare dhe të minoriteteve, si dhe promovon vlerat e përbashkëta që ndan populli shqiptar me shoqëritë e vendeve fqinje dhe atyre perëndimore.

18.5 Grumbullimi dhe përpunimi i informacionit për çështje të sigurimit të vendit është përgjegjësi e organeve të specializuara të shtetit. E gjithë veprimtaria e shërbimeve informative (të

zbulimit dhe të kundërzbulimit), zhvillohet mbi bazën e ligjeve të veçanta të miratuara nga Kuvendi. Ato kërkojnë dhe sigurojnë informacion edhe duke bashkëvepruar me organizmat ndërkombëtarë dhe të vendeve të tjera.

## VII. KONCEPTI STRATEGJIK I SIGURIMIT

Strategjia e sigurimit të Republikës së Shqipërisë është një dokument për veprim, dinamik, me karakter kombëtar dhe jo partiak. Strategjia e sigurimit mbështetet në pikëpamjet e politikës shtetërore për sigurimin e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit demokratik shqiptar ndaj kërcënimeve e rreziqeve të brendshme dhe të jashtme, në mbrojtjen e zhvillimin e interesave dhe në mundësitë reale të vendit.

19. Koncepti strategjik i sigurimit synon: mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtarë, përfshirjen aktive të Shqipërisë në përpjekjet ndërkombëtare, për të arritur një sigurim të ri rajonal e europian; pjesëmarrjen për parandalimin dhe menaxhimin e krizave e të konflikteve dhe vendosjen e paqes në kuadrin e brendshëm e atë ndërkombëtar; arritjen e stabilitetit të brendshëm, si dhe mbrojtjen e qytetarëve shqiptarë kudo që ata jetojnë.

Mbi këtë bazë, udhëheqja strategjike nëpërmjet platformave dhe programeve strategjike të veçanta, politikave efektive dhe transparente, arritjes së vullnetit politik të përbashkët dhe përdorimit të të gjithë elementëve të fuqisë kombëtare duhet të sigurojë kurdoherë: ushtrimin e paprekshmërisë së sovranitetit; mbrojtjen e pavarësisë dhe të tërësisë territoriale; mbrojtjen e lirive e të drejtave të njeriut, të jetës së qytetarëve dhe të pronës; mbrojtjen dhe zhvillimin e institucioneve kushtetuese demokratike me rrugë e mjete ligjore; arritjen e stabilitetit; zhvillimin e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve të sinqerta me partnerët dhe integrimin në strukturat euroatlantike. Baza të sigurimit kombëtar në kuadrin e brendshëm janë institucionet përkatëse të shtetit shqiptar, ndërsa në kuadrin e jashtëm janë NATO, PpP, OSBE dhe OKB.

20. Ngritja e sistemit të sigurisë së vendit parashikohet:

20.1. Për kohë paqeje ose në kushtet e situatave normale. Mbrojtja e paqes, pavarësisë dhe sistemit demokratik në situata normale synon realizimin e tre objektivave themelore:

20.1.a. Mbrojtja dhe funksionimi normal i rendit kushtetues, për të siguruar një stabilitet e zhvillim të brendshëm afatgjatë, duke parandaluar dhe mënjeluar veprimin e kërcënimeve e rreziqeve të brendshme.

20.1.b. Mbrojtja e pavarësisë dhe e integritetit territorial, duke synuar shmangien e vendit nga konfliktet ushtarake ose parandalimin e konflikteve ushtarake.

20.1.c. Zhvillimi e konsolidimi i procesit të paqes në Europë dhe rajon, nëpërmjet zhvillimit të politikës së jashtme si një instrument strategjik për të afirmuar dhe ushtruar sovranitetin në nivel ndërkombëtar, bashkëpunimin e partneritetin me institucionet dhe shtetet në kuadrin bilateral.

20.2. Për gjendje të jashtëzakonshme ose në kushtet e katastrofave natyrore, teknologjike ose të shkaktuara nga njerëzit dhe në rastet e krizave të brendshme me natyrë të ndryshme, si dhe të zhvillimit të konflikteve në kufijtë rajonalë. Gjendjet e jashtëzakonshme janë proceset më të vështira të sigurisë. Përballimi i pasojave dhe kapërcimi i tyre, duke minimizuar efektet negative dhe kthimin brenda një kohe sa më të shkurtër në kushte normale, përbëjnë objektin kryesor të sigurimit. Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e shtetit shqiptar, për çdo rast konkret, gjendja e jashtëzakonshme e plotë ose lokale ka për qëllim:

20.2.a. të parandalojë ose mënjanojë pasojat e fatkeqësive të shkaktuara si rezultat i katastrofave natyrore, teknologjike ose të shkaktuara nga njerëzit. Mbrojtja civile është një instrument strategjik i autoriteteve civile për të mbështetur popullsinë civile në rastet e katastrofave natyrore dhe të situatave të krizës në kuadrin vendor ose kombëtar;

20.2.b. të parandalojë ose mënjanojë pasojat e krizave të brendshme me natyrë të ndryshme. Rastet më tipike të krizave të tilla mund të sjellin shkeljen e rendit kushtetues, të sigurisë e të pronës publike dhe dëmtimin ose paralizimin e institucioneve demokratike të shtetit;

20.2.c. të parandalojë dhe mënjanojë pasojat e konflikteve në rajon. Përgjithësisht, në këto kriza mbizotërojnë situatat e përballimit të krizave humanitare të refugjatëve e të të dëbuarve me dhunë, të

ruajtjes së kufirit nga depërtimet e mundshme të elementëve me rrezikshmëri për sigurinë e qytetarëve shqiptarë dhe parandalimin e trafikeve të ndryshme, si dhe mënjanimin e shtrirjes së konfliktit në drejtim të territorit shqiptar.

20.3. Për gjendjen e luftës, në një pjesë ose në të gjithë territorin shqiptar. Forcat e Armatosura janë instrumenti kryesor që angazhohen dhe realizojnë luftën në përputhje me objektivat politikë. Shpallja e gjendjes së luftës, mobilizimi i burimeve të vendit dhe drejtimi i saj janë kompetencë e udhëheqjes civile që ka attribute kushtetuese.

## VIII. OBJEKTIVAT E SIGURIMIT

Prakticiteti dhe suksesi i realizimit të politikës së sigurimit ndikohet së tepërmi nga cilësia dhe gjërësia e objektivave parësorë. Nëpërmjet tyre synohet të krijohet një lidhje thelbësore ndërvepruese e interesave kombëtarë, nevojave dhe mundësive reale për të sotmen dhe të ardhmen e sigurisë së vendit. Si objektiva të strategjisë së sigurimit mund të veçojmë ato në planin afatshkurtër dhe në planin afatgjatë.

21. Në planin afatshkurtër qëndron sipërmarrja imperative për realizimin e këtyre objektivave parësorë:

21.1. Të jemi në kohë për vendosjen e paqes e të sigurisë në vend. Në këtë kontekst, stabiliteti i brendshëm i vendit do të arrihet paralelisht me forcimin e shtetit ligjor për të mbrojtur qytetarët, shoqërinë civile dhe shtetin nga veprimet antiligjore. Vendosja e rendit të brendshëm është një element i parandalimit të krizave në Shqipëri.

21.2. Ndërtimi i marrëdhënieve me partnerët për të krijuar një frymë dhe një rend të ri rajonal nëpërmjet dialogut, bashkëpunimit e mirëbesimit. Në themel të këtij vizioni strategjik qëndrojnë realizimi i të gjitha obligimeve ndërkombëtare për një zgjidhje definitive e të drejtë të statusit të ardhshëm të Kosovës dhe i kthimit të Shqipërisë në një faktor sigurie e stabiliteti në Europën Juglindore. Kushtet e reja të krijuara kërkojnë që Shqipëria të parashohë dhe të zhvillojë strategjinë e sigurimit me integrimin në strukturat ekonomike dhe të sigurimit kolektiv (NATO, BE).

21.3. Zhvillimi i koncepteve, institucioneve dhe instrumenteve të sigurimit të vendit si procese që të përcaktojnë suksesin e tranzicionit për në demokraci dhe ekonominë e tregut. Këto duhen parë si një aftësi për të mbrojtur interesat kombëtarë dhe si një përgjegjësi për të vepruar ndaj çdo situatë kërcënuese dhe parashikimit të të papriturave të së ardhmes. Një Shqipëri e stabilizuar, e zhvilluar dhe e sigurtë do të përbëjë bazën e prosperitetit për popullin shqiptar dhe një element paqeje në rajon.

21.4. Stabilizimi dhe zhvillimi i ekonomisë si garanci e sigurisë së vendit. Faktori ekonomik ka një ndikim të fuqishëm në plotësimin e interesave të qytetarëve, shoqërisë dhe shtetit. Nëpërmjet tij mënjanohej ose eliminohej papunësia, emigracioni masiv e klandestin dhe rritet mirëqenia e besimi për të ardhmen. Stabiliteti dhe zhvillimi ekonomik lidhen me aftësitë për ndërtimin e infrastrukturës, pjesëmarrjen dhe bashkëveprimin me tregjet rajonale e europiane. Këto do të mundësojnë shfrytëzimin e pozitës gjeostrategjike të vendit tonë dhe kthimin e saj në një qendër komunikimi të rëndësishme në rajon.

22. Në planin afatgjatë do të mbahen parasysh këto objektiva përparësorë:

22.1. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO dhe BE një objektiv përparësor dhe afatgjatë i politikës së sigurimit. Shqipëria, por edhe shtete të fuqishme nuk e mbështesin sigurinë e vendit thjeshtë në forcat e veta, por gjithnjë e më shumë te përpjekjet e përbashkëta, integrimi dhe bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë.

22.2. Zhvillimi i legjislacionit në harmoni dhe në përputhje të plotë me normat e standardet e Bashkimit Europian. Strategjia e shtetit synon që të zgjerohet dhe të thellohet bashkëpunimi në këtë fushë edhe në arenën ndërkombëtare. Zhvillimi i legjislacionit dhe funksionimi efektiv i organeve juridike janë garanci afatgjatë për të mbrojtur interesat kombëtarë dhe për integrimin e Shqipërisë në Europë.

22.3. Arritja në praktikë e standardeve të një shoqërie demokratike në fushën e të drejtave njerëzore. Individit, shoqëria dhe shteti kanë detyrime të përbashkëta për sigurimin e vendit, të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje. Së bashku ato përbëjnë strukturën e sigurimit të Republikës së Shqipërisë. Shkelja e këtyre detyrimeve, qoftë edhe nga njëra palë, dëmton rëndë sigurinë e vendit.

22.4. Zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare, duke mbështetur mbrojtjen e zhvillimin e vlerave

kombëtare pa ndryshim të kufijve me dhunë. Stabiliteti rajonal dhe demokratizimi i Ballkanit konsiderohen si kushtet drejt integritetit të vendeve ballkanike në Perëndim. Shqipëria synon të jetë një partner aktiv në politikën rajonale. Në këtë kuadër, çështja kombëtare shqiptare synohet të arrihet nëpërmjet zgjidhjeve që sigurojnë garanci afatgjatë dhe të pranueshme.

22.5. Restaurimi dhe zhvillimi i burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit janë një tjetër përparësi afatgjatë për sigurimin. Burimet natyrore dhe mjedisi janë elemente të pashtershme të gjenerimit të instrumenteve të sigurisë. Menaxhimi i burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit janë me rëndësi strategjike për jetën e njeriut dhe sigurinë e vendit.

22.6. Ristrukturimi dhe rindërtimi i forcave të armatosura nën kontrollin demokratik të autoriteteve civile ligjore. Aftësia mbrojtëse e tërësisë territoriale dhe pavarësisë së vendit nëpërmjet forcave të armatosura mbetet shprehje e vullnetit të popullit për të siguruar vetëveten dhe që nuk kërcënon vendet e tjera.

## PJESA E TRETË

### DREJTIMET KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË ELEMENTEVE PËRBËRËSE TË STRATEGJISË SË SIGURIMIT

23. Sigurimi i vendit është një politikë shumëdimensionale, ashtu siç është realiteti i rrezeve dhe realizimi i objektivave të interesave kombëtarë. Asnjë politikë dhe element i veçantë nuk mund të jenë të suksesshëm, pa një integritet të tyre dhe të aftësive për t'u ndeshur me sfidat e së ardhmes, duke ruajtur balancën ndërmjet kuadrit aktual të rrezeve të kërcënimeve, pamjaftueshmërisë së instrumenteve të sigurisë dhe kërkesave të ndryshmeve afatshkurtër e afatgjatë në funksion të realizimit të strategjisë së sigurimit. Përgatitja dhe zhvillimi i sigurimit të vendit nuk mund të kufizohet në efektivitetin e ndonjë drejtimi të caktuar, por është parakusht fokusimi në të gjitha drejtimet që mundësojnë aftësinë për t'u përgjigjur spektrit të gjerë të krizave të mundshme në kohë dhe me efektivitet.

## IX. DIPLOMACIA

24. Diplomacia është instrumenti më i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi ndërkombëtar të përshtatshëm për parandalimin e krizave e të konflikteve, zgjidhjen e tyre me mjete paqësore dhe mundësimin e bashkëpunimit me fqinjët, partnerët e institucionet ndërkombëtare. Politika e integritetit në strukturat euroatlantike, europiane dhe rajonale përbën objektivin dhe zgjidhjen strategjike themelore për sigurinë e vendit dhe mbrojtjen e interesave kombëtarë. Suksesi i realizimeve të kësaj politike varet nga arritja e stabilitetit të brendshëm dhe e zhvillimit të Shqipërisë si një element progresiv në proceset integruuese të sigurimit ndërkombëtar dhe rajonal.

24.1. Pakti i Stabilitetit është përparësia kryesore e politikës së jashtme të Shqipërisë. Shqipëria është e angazhuar për të dhënë ndihmesën e saj maksimale në zbatimin e objektivave të Paktit të Stabilitetit. Vendi ynë e konsideron Paktin e Stabilitetit si një sfidë të së tashmes e të së ardhmes, e cila do të shënojë transformimin rrënjësor të Europës Juglindore drejt paqes, demokracisë dhe prosperitetit ekonomik.

24.2. Integrimi në strukturat euroatlantike mbetet një drejtim parësor i politikës së jashtme. Ngritja e nivelit të marrëdhënieve kontraktuale me institucionet dhe vendet demokratike dhe zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me partnerët kryesor euroatlantikë si NATO, OSBE e KE, përbën një objektiv strategjik tashmë të konsoliduar për Shqipërinë. Prania afatgjatë e Aleancës Atlantike në rajon, konsiderohet një garanci dhe ndihmesë thelbësore për paqen dhe stabilitetin në Europën Juglindore.

24.3. Vlerësimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka një rëndësi përparësore e të veçantë. Roli i SHBA-së në konsolidimin e demokracisë, të institucioneve të shtetit ligjor, në forcimin e sigurisë dhe luftën kundër krimit në Shqipëri, ka qenë dhe mbetet thelbësor. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë një ndihmesë të pazëvendësueshme në zgjidhjen e konfliktit në Kosovë, në normalizimin e situatës dhe ndërtimin e një shoqërie shumetnike, duke synuar arritjen e një zgjidhjeje afatgjatë.

24.4. Shqipëria i kushton një rëndësi parësore zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me

Bashkimin European. Marrëdhëniet politike mjaft të mira me BE-në kanë përcaktuar edhe mbështetjen e fuqishme e të gjithanshme që i është dhënë vendit tonë nga ky organizëm ndërkombëtar. Shqipëria do të synojë forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh me vendet e Bashkimit European.

24.5. Shqipëria e konsideron politikën e saj rajonale si një nga përparësitë e saj bazë. Një peshë të veçantë në këtë kuadër do të zënë marrëdhëniet strategjike me Italinë. Me Greqinë na lidh një gamë e gjërë interesash dhe objektivash të përbashkëta. Zhvillime të mëtejshme pritet të kenë marrëdhëniet tradicionale shumë të mira me Turqinë, si dhe marrëdhëniet me Maqedoninë dhe vendet e tjera të Europës Juglindore, të cilat do të kenë impakt pozitiv edhe për sigurinë në rajon e më gjerë.

24.6. Shqipëria do t'i kushtojë vëmendjen e duhur dhe do të jetë aktive në përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për një zgjidhje të qëndrueshme të çështjes së Kosovës.

## X. MBROJTJA E RENDIT PUBLIK

25. Ndërtimi dhe funksionimi normal i institucioneve demokratike shtetërore dhe i shtetit ligjor, si rruga më efektive për arritjen e stabilitetit e të sigurisë së brendshme. Kalimi në demokraci dhe ndërtimi i saj nëpërmjet sigurimit të stabilitetit të brendshëm, janë penguar seriozisht nga mosdashja dhe paaftësia për ndërtimin e funksionimin normal të rendit kushtetues.

25.1. E gjithë veprimtaria shtetërore, e shoqërisë dhe e individit duhet të përshkohen nga zbatimi i ligjit. Qytetarët, shoqëria dhe shteti përbëjnë një unitet të përherëshëm të ekzistencës së Shqipërisë, të cilët duhet të respektojnë detyrimet përkatëse. Realizimi dhe mbrojtja e interesave të tyre, të shprehura në Kushtetutë e ligje, është detyrë e institucioneve demokratike shtetërore. Të gjitha këto përbëjnë strukturën e sigurimit të Shqipërisë, ndërsa Kushtetuta është elementi thelbësor i kësaj strukture.

25.2. Suksesi i tranzicionit për në demokraci dhe stabiliteti i brendshëm do të konsolidohen paralelisht me rritjen e aftësisë ekzekutive të organeve juridike, për të goditur krimin në të gjitha natyrat e shfaqjes së tij, mbi bazën e programimit e unifikimit të strategjisë dhe zhvillimin e vijueshëm të bashkëveprimit në kuadrin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

25.3. Ndërtimi dhe funksionimi i organizmave ndërmënyrorë për të luftuar krimin, drogën, kontrabandën, korrupsionin e trafiket e ndryshme, rritja e efektivitetit të strukturave të policisë për të parandaluar e luftuar këto dhe për të mbrojtur rendin publik, si dhe rritja e bashkëpunimit me administratën publike dhe shoqërinë civile përbëjnë drejtimet kryesore të një strukture dinamike dhe efektive të policisë në realizimin e misionit të saj.

25.4. Lufta kundër kriminalitetit dhe mbrojtja e rendit publik janë detyrat kryesore të Policisë së Rendit. Forcat e policisë janë elementi kryesor i shtetit për sigurimin e stabilitetit të brendshëm dhe të parat që ndeshen me përballimin e rreziqeve të brendshme. Natyrat komplekse, masiviteti dhe demonstrimet profesionale të kriminalitetit në vend kërkojnë jo vetëm angazhimin maksimal për të rikthyer qetësinë dhe besimin e humbur, por para së gjithash krijimin e strukturave efektive, rritjen e profesionalizmit dhe modernizimin e pajisjeve të tyre.

25.5. Sigurimi dhe shkëmbimi i informacionit të nevojshëm për parandalimin e krimit e të krizave të brendshme. Ne nuk mund të përjashtojmë mundësinë e ekzistencës së grupeve kriminale dhe të trazirave publike. Bazë për zbulimin dhe parandalimin në kohë të tyre është funksionimi i një sistemi efektiv të informimit sekret. Ky shërbim duhet të bashkëveprojë në mënyrën më të plotë me politikën shtetërore dhe përdorimin e forcave përkatëse për të bërë parandalimin në kohë të tyre.

25.6. Rritja e rolit aktiv të bashkëpunimit ndërkombëtar për të luftuar krimin e organizuar. Bashkëpunimi me fqinjët, partnerët dhe institucionet ndërkombëtare do të mundësojnë rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit, rritjen e sigurisë së brendshme dhe nuk do të lejojë që Shqipëria të kthehet në një pikë hyrjeje për emigrantët ilegalë dhe në një platformë për zhvillimin e krimit të organizuar e terrorizmin.

25.7. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të qytetarëve, si dhe e pronës janë garanci për funksionimin normal të shtetit ligjor. Ndërtimi i shoqërisë civile demokratike ka në themel respektin për njeriun e pronën. Zhvillimi i institucioneve shtetërore demokratike, bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe parandalimi i dhunës e i veprimeve të tjera që krijojnë shkelje të të drejtave të



njeriut, do të jenë objekti kryesor i përpjekjeve tona për mbrojtjen e Kushtetutës.

## XI. POLITIKA EKONOMIKO-FINANCIARE

Mbështetja e Paktit të Stabilitetit përfaqëson një nga drejtimet kryesore të politikës ekonomiko-financiare. Ky Pakt, i zbatuar me një mendësi të re bashkëpunimi dhe bashkëjetese midis vendeve të Europës Juglindore, do ta shkëpusë këtë rajon nga e kaluara dhe do të promovojë rimëkëmbjen e rajonit mbi bazën e parimeve demokratike.

26. Zhvillimi ekonomiko-financiar është rruga që garanton sigurinë dhe stabilitetin e brendshëm, si dhe plotësimin e interesave të qytetarëve e shoqërisë. Kalimi në ekonominë e tregut është shoqëruar me kriza ekonomike, që janë përkeqësuar kohë pas kohe si rezultat i proceseve reformuese të parregullta, i mungesës së efektivitetit dhe i zhvillimit të kriminologjik. Këto kriza mbartin pasojat si: lëvizja demografike e pakontrolluar, emigracioni masiv, rritja e papunësisë, humbja e pozitave në tregjet ekonomike ndërkombëtare, inflacioni etj.

26.1. Nxitja dhe zhvillimi i nismës së tregut të lirë, zhvillimi teknologjik, përsheptimi dhe efektiviteti i reformave ekonomike dhe zhvillimi i infrastrukturës për të krijuar shfrytëzimin e pozitës gjeostrategjike të Shqipërisë, si nyje e rëndësishme komunikimi në Ballkan dhe Lindje-Perëndim janë elementet që do të ndikojnë drejtpërdrejtë në sigurimin e vendit edhe në kuadër më të gjerë.

26.2. Shfrytëzimi në mënyrë racionale i burimeve kombëtare për ndërtimin dhe zhvillimin e instrumenteve të sigurimit, në përputhje me standardet e shtetit demokratik, mundësitë dhe nevojat e Shqipërisë. Shqipëria është një vend i vogël, me gjëndje të vështirë ekonomiko-sociale, me probleme të mprehta të stabilitetit të brendshëm dhe e ndodhur në rajon të pasigurtë me konflikte të mundshme. Përcaktimi i kufijve të mjaftueshëm të madhësisë së instrumenteve të sigurimit për mbrojtjen e vendit dhe ruajtjen e stabilitetit të brendshëm përbën një proces të vështirë.

Në këto kushte, politika e sigurimit synon të bëjë shpërndarjen e burimeve duke i dhënë përparësi instrumenteve për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të brendshëm, krijimit të rezervave të nevojshme për sigurinë, si dhe investimit për ndërtimin e një force të armatosur të aftë të kryejë misionin kushtetues dhe të mundësojë standardizimin me strukturat e NATO-s.

26.3. Lufta kundër korrupsionit dhe fitimeve të pandershme do të rrisë efektivitetin e reformave ekonomike dhe besimin në sistemin tonë ekonomiko-financiar. Tashmë ne kemi hyrë në një sistem të ri ekonomik, i cili nuk duhet të zhgënjejë njerëzit tanë dhe të krijojë premisat e pasurimit në rrugë të pandershme. Nuk duhet të lejohet që te qytetarët të krijohej bindja se në këtë sistem ekonomik është e lehtë të ushtrosh veprimtarinë kriminale të korrupsionit dhe të përfitimeve të pandershme. Korrupsioni, veçanërisht kur ai mplekset me politikën, bëhet një element shumë i rrezikshëm për destabilitetin, disnivelim ekonomiko-financiar të qytetarëve dhe konflikte të brendshme sociale.

26.4. Përgjigjja për parandalimin e rreziqeve të brendshme është e lidhur drejtpërdrejtë me zhvillimin ekonomik. Aftësia e organizmave shtetërorë për të vënë në veprim ndihmesat ndërkombëtare për zhvillimin ekonomik do të gjenerojë më shumë vende pune, do të rrisë të ardhurat, do të zhvillojë kapacitetet e brendshme dhe përparimin social në nivelin e jetesës së qytetarëve.

## XII. MBROJTJA CIVILE

27. Ridimensionimi i çështjeve të mbrojtjes civile kërkon një përshtatje të tij me rreziqet që kërcënojnë jetën dhe pronën e qytetarëve dhe të shoqërisë. Përvoja e deritanishme tregon se përmbushja e detyrave të shtetit në kuadrin e mbrojtjes civile ka qenë e kufizuar për shkak të mungesës së strukturave të mjaftueshme. Ballafaqimi me fenomenet e ardhjes së refugjatëve, të mbetjeve toksike e teknologjike, të temperaturave shumë të larta, të përmblytjeve masive dhe e rreziqeve të tjera potenciale me origjinë natyrore e teknologjike parashatrojnë nevojën e organizimit të vijueshëm të strukturave të posaçme të mbrojtjes civile në pushtetin qendror, atë vendor dhe në Forcat e Armatosura. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre me organizmat joqeveritarë dhe bashkëveprimi në kuadrin ndërkombëtar do të

mundësojnë një nivel më të lartë cilësor organizativ, përgatitjeje dhe efektshmërie.

### XIII. MBROJTJA E MJEDISIT DHE E SHËNDETIT

28. Ne vazhdojmë të përjetojmë një periudhë të vështirë të mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit. Këto mund të pengojnë projektet për zhvillim dhe të bëhen shkak për destabilizim e pasiguri për jetën. Mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit publik nga sëmundjet masive mbeten një nga përparësitë strategjike të sigurimit. Shteti, nëpërmjet zbatimit të ligjit, financimeve të posaçme, sensibilizimit të opinionit publik dhe zgjerimit të programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar do të mundësojë mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik, duke e vlerësuar atë si rrugën drejt prosperitetit dhe të rritjes së aftësive të brendshme.

### XIV. MARRËDHËNIET ME OPINIONIN PUBLIK

29. Informimi i publikut e transparenca dhe sigurimi i konsensusit për zgjidhjet strategjike dhe shtimin e burimeve për sigurimin kombëtar shihen si vendimtarë për suksesin e strategjisë së sigurimit. Institucionet shtetërore të sigurimit do të synojnë procedura normale për dhënien e informacionit dhe nuk do të lejojnë që ai të përdoret për qëllime mashtrimi të ndërgjegjes së opinionit publik.

Çështjet e përparësisë së zgjidhjeve strategjike dhe të shtimit të burimeve të sigurimit do t'i nënshtrohen debatit dhe marrjes së pëlqimit të opinionit publik. Taksapaguesit shqiptarë do të kenë informacionin dhe transparençën e nevojshme për përdorimin e burimeve. Kjo rrugë do të ndihmojë në krijimin e besimit dhe të kuptuarit më mirë të përparësive strategjike që duhen ndjekur për të realizuar objektivat dhe interesat kombëtarë.

Sistemi i sigurimit të vendit duhet t'i bindë dhe të jetë i besueshëm për qytetarët për qëllimet dhe efektivitetin e tij. Edhe sistemi më i mirë i sigurimit, në qoftë se kontestohet dhe bëhet i pabesueshëm për qytetarët, është i paefektshëm.

### XV. POLITIKA E MBROJTJES

30. Mbrojtja e vendit është përgjegjësia kryesore e shoqërisë shqiptare dhe e Forcave të saj të Armatosura. Nën dritën e transformimeve të rëndësishme që kanë ndodhur dhe të atyre të pritshme, përpyqet për gjetje të reja dhe përshtatje të politikës së mbrojtjes janë të qarta.

30.1. Qeveria Shqiptare e konsideron rolin e planit të veprimeve për anëtarësim si ndihmë e qenësishme në përshpejtimin e procesit të integritetit të vendit në strukturat euroatlantike dhe si një ndihmesë mjaft e rëndësishme në shërbim të arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit dhe të paqes në rajonin tonë. Ndërkohë, Qeveria Shqiptare mbetet tërësisht e angazhuar në zhvillimin dhe pjesëmarrjen e plotë në programet e përbashkëta në kuadër të Partneritetit për Paqe dhe të PARP-it.

30.2. Politika e mbrojtjes duhet të zhvillojë edhe më tej konceptet e rolet e reja për realizimin e misionit kushtetues dhe të kërkesave aktuale të shoqërisë, duke u përqendruar në: zhvillimin e programeve për t'iu përgjigjur zbatimit të standardeve të NATO-s në fushën e politikës së mbrojtjes e të sigurimit; përfshirjen aktive të vendit tonë nismat rajonale politiko-ushtarake dhe zhvillimin e marrëdhënieve me vendet e tjera; përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes e të Forcave të Armatosura, në përputhje me standardet e vendeve anëtare të NATO-s dhe Kushtetutën tonë; zhvillimin e ushtrimit të kontrollit civil ligjor ndaj forcave të armatosura dhe të marrëdhënieve civilo-ushtarake; përshtatjen e procesit të buxhetit të mbrojtjes në përputhje me standardet e NATO-s dhe të vendeve anëtare; krijimin dhe konsolidimin e organizmave të menaxhimit të krizave sipas standardeve të NATO-s dhe të afta të ndërthuren me strukturat e sigurimit kolektiv; përgatitjen dhe kualifikimin e personelit për të shërbyer në strukturat politiko-ushtarake të NATO-s.

30.3. Reformimi dhe ristrukturimi i Forcave të Armatosura të mjaftueshme, cilësore dhe të afta për të realizuar misionin kushtetues dhe mundësimin e integritetit afatgjatë në strukturat e NATO-s, duke u përqendruar në: përgatitjen dhe miratimin e konceptit për reformimin dhe zhvillimin e Forcave të

Armatosura për periudhën 1999-2009, me synimin e plotësimit të standardeve për anëtarësimin në NATO; realizimin e Programit Individual të Programit të Partneritetit me NATO-n, duke u përqendruar në realizimin e objektivave dhe të përparësive të bashkëpunimit; pjesëmarrjen aktive dhe me përgjegjësi në procesin e planifikimit dhe të rishikimit të PpP; plotësimin e objektivave të interoperabilitetit dhe të standardeve të NATO-s, veçanërisht në fushat operacionale, të administrimit dhe të pajisjeve; zhvillimin e Doktrinës Ushtarake të Forcave tona të Armatosura bazuar në parimet e Aleancës dhe të doktrinave të vendeve anëtare; stërvitjen dhe përgatitjen e specializuar të forcave për pjesëmarrje në operacionet shumëkombëshe nën komandën e NATO-s dhe të oficerëve për të shërbyer në shtabet shumëkombëshe.

30.4. Zhvillimi i ekonomisë dhe industrisë së mbrojtjes, në përputhje me mundësitë tona reale dhe të integritetit të tyre me ato të vendeve anëtare të NATO-s, duke u përqendruar: në zhvillimin e programuar për përshtatjen e burimeve, të industrisë dhe prokurimeve të mbrojtjes, sipas standardeve të vendeve anëtare të Aleancës; në shqyrtimin dhe zhvillimin e mundësive reale për bashkëpunimin në këto fusha me këto vende dhe në studimin e mundësive për të arritur kompatibilitetin dhe në përzgjedhjen e programeve të modernizimit të infrastrukturës, komunikimit dhe të sistemit të informacionit në përputhje me standardet e NATO-s.

## PJESA E KATËRT UDHËHEQJA STRATEGJIKE E SIGURIMIT

### XVI. BAZAT KUSHTETUESE TË UDHËHEQJES STRATEGJIKE TË SIGURIMIT

31. Udhëheqja strategjike harton e realizon politikën shumëdimensionale të sigurimit të vendit.

31.1. Ushtrimi i veprimtarisë së udhëheqjes strategjike të sigurimit synon: realizimin e drejtimit dhe të kontrollit strategjik të sigurimit të vendit; zhvillimin e harmonizuar të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve, organeve e funksioneve shtetërore; shqyrtimin e koncepteve, interesave, objektivave e rrugëve për realizimin e tyre; integrimin e politikave shtetërore për përballimin e rreziqeve të brendshme e të jashtme që kërcënojnë sigurinë e vendit; kontrollin demokratik të autoriteteve civile ligjore ndaj Forcave të Armatosura; arritjen e mirëkuptimit dhe të mbështetjes së opinionit publik e të forcave të politike për problemet thelbësore dhe që përbëjnë interes kombëtar.

31.2. Përcaktimet kushtetuese për Kuvendin, Presidentin e Republikës, Këshillin e Sigurimit, Kryeministrin, Këshillin e Ministrave dhe Ministrin e Mbrojtjes ngarkojnë këto institucione, organe e funksione shtetërore të marrin përgjegjësitë e udhëheqjes strategjike të sigurimit të vendit. Ekuilibrimi dhe harmonizimi i veprimtarisë e përgjegjësisë të tyre mbështetet në shprehjen dhe zbatimin e parimit të “Kontrollit dhe të Balancës së pushteteve”. Udhëheqja strategjike realizohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet e miratuara nga Kuvendi, dekretet e Presidentit dhe vendimet e Këshillit të Ministrave (skema nr.1).

31.3. Zbatimi i kompetencave demokratike ligjore kryhet në përshtatje me gjendjet e sigurisë, kohën e dobishme dhe efektivitetin e duhur. Dinamizmi në rritje i strategjisë së sigurimit dhe përfshirja e saj si një politikë e përgjithshme shtetërore për ruajtjen e paqes e të mbijetesës dhe zhvillimin e konsolidimit të institucioneve demokratike ndikojnë në mënyrë të dukshme për veprimtarinë e udhëheqjes strategjike të sigurimit.

Udhëheqja strategjike i ushtron funksionet e saj në kushtet e gjendjes normale d.m.th. në kohë paqeje, të gjendjes së jashtëzakonshme d.m.th. në kohë krizash dhe të gjendjes së konfliktit d.m.th. në kohë lufte.

Në çdo rrethanë, funksioni themelor i udhëheqjes strategjike është mbrojtja dhe zhvillimi i paqes, i demokracisë dhe institucioneve demokratike, i ekonomisë së tregut dhe i lirive e të drejtave të njeriut, në një shtet sovran e të pavarur dhe në kuadrin e kontekstit ndërkombëtar. Suksesi i udhëheqjes strategjike parashtron nevojën e përpjekjeve të organizuara pragmatike dhe planifikimin afatgjatë të përshtatjes së koncepteve e strukturave të sigurimit për të qenë në gjendje të përballojë të sotmen dhe sfidat e së ardhmes.

## XVII. PËRGJEGJËSITË KUSHTETUESE TË UDHËHEQJES STRATEGJIKE TË SIGURIMIT

32. Kuvendi është organi i vetëm që miraton ligje në fushën e sigurimit të vendit dhe që kontrollon zbatimin e tyre. Kuvendi ka kompetenca kushtetuese për shpalljen e gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme, mobilizimit të pjesshëm e të përgjithshëm, për ratifikimin e marrëveshjeve dhe shqyrtimin e miratimit të buxhetit e të politikave shtetërore.

Funksioni shumë i rëndësishëm i kontrollit demokratik parlamentar ushtrohet nëpërmjet formave legale, drejtpërdrejt nga Kuvendi dhe komisionet përkatëse. Në këtë kuadër, veprimtaria e tij ndaj organeve ekzekutive përqendrohet në zbatimin e ligjeve, të buxhetit, të politikave të ndjekura për shmangien dhe minimizimin e rreziqeve për sigurinë, si dhe në realizimin e planeve e të programeve të zhvillimit të instrumenteve të sigurisë.

Kuvendi, si një mjedis politik pluralist dhe me përfaqësues legjislativë të zgjedhur nga vota e popullit, mundëson mbështetjen e opinionit publik dhe merr nisma të rëndësishme kushtetuese për realizimin e interesave kombëtarë dhe të qëndrimeve afatgjata për probleme themelore të sigurimit.

33. Presidenti i Republikës, me cilësitë kushtetuese të Kryetarit të Shtetit, të përfaqësimit të unitetit të popullit, të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe të Kryetarit të Këshillit të Sigurimit është funksionari më i lartë përgjegjës për realizimin e misionit, parimeve e objektivave të sigurimit të vendit dhe mbrojtjen e zhvillimin e interesave kombëtarë.

Detyrat konstitucionale të mësipërme i japin Presidentit të Republikës përgjegjësi kryesore dhe misione sublimë për parashtrimin e strategjisë së sigurimit, për drejtimin strategjik të sigurimit të vendit dhe për ushtrimin e autoritetit komandues ndaj Forcave të Armatosura (neni 168, pika 2, 3 e Kushtetutës). Realizimi i kontrollit demokratik të autoriteteve civile ligjore mbi Forcat e Armatosura përbën thelbin e kontrollit demokratik për çështjet e sigurimit të vendit dhe të marrëdhënieve civilo-ushtarake (neni 168, pika 2 dhe neni 169 i Kushtetutës).

33.1. Këshilli i Sigurimit është organ këshillimor i Presidentit (neni 168, pika 3 e Kushtetutës), i cili ka si detyrë kryesore formulimin dhe miratimin e strategjisë së sigurimit të Republikës së Shqipërisë, të cilën e paraqet për miratim në parim në Kuvend.

Përbërja, detyrat dhe funksionimi i Këshillit të Sigurimit përcaktohen me ligj.

34. Këshilli i Ministrave është organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv. Ai përgjigjet për zbatimin e strategjisë së sigurimit dhe gjendjen e zhvillimin e instrumenteve të sigurimit dhe të burimeve kombëtare. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesore të politikës së sigurimit, i parashtron ato në Këshillin e Sigurimit dhe drejton veprimtarinë e organeve dhe të institucioneve, në vartësi në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet.

34.1. Kryeministri është funksionari më i lartë i pushtetit ekzekutiv. Ai koncepton dhe paraqet drejtimit kryesore të politikës së sigurimit dhe siguron bashkërendimin e zbatimit të tyre në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën.

34.2. Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për drejtimin, kontrollin dhe materializimin e politikës së sigurimit brenda sektorit që ka në kompetencë. Ai përgjigjet para Kuvendit, Presidentit dhe Këshillit të Ministrave për ushtrimin e funksioneve të tij dhe realizimin e politikave të miratuara. E gjithë veprimtaria e tij mbështetet në zbatimin e ligjeve e të Kushtetutës.

## XVIII. UDHËHEQJA VENDORE E SIGURIMIT

35. Ekzistenca dhe funksionimi i pushtetit vendor në interes të Sigurimit është një nevojë e të vepruarit me shpejtësi dhe në përputhje me interesat e përgjithshëm dhe strategjinë e sigurimit në çdo nivel shtetëror. Njësitë të pushtetit vendor u delegohen me ligj kompetenca të administratës shtetërore (neni 110 i Kushtetutës).

Brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe detyrave që parashtron strategjia e sigurimit, pushteti vendor merret me planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin e masave për përballimin e situatave të

katastrofave natyrore me mundësitë e mjetet që kanë në dispozicion dhe shkëmben informacion me udhëheqjen strategjike.

Organizimi, detyrat dhe funksionimi i pushtetit vendor në interes të sigurimit të vendit përcaktohen me ligj.

## PËRFUNDIME

Strategjia e sigurimit të Republikës së Shqipërisë merr si pikënisje detyrimet kushtetuese e ligjore të shtetit për sigurinë e vendit të ballafaquara me gjendjet aktuale e perspektive të sigurisë, si dhe natyrën integrale të sigurimit.

Formulimi dhe miratimi i këtij dokumenti është shprehje e debatit dhe e konsensusit politik për çështjet e sigurimit, e nevojës për t'i analizuar e parashtruar ngjarjet dhe objektivat në mënyrë reale, si dhe e përcaktimit të zgjidhjeve strategjike në përputhje me interesat e mbijetesës.

Qëllimi i këtij dokumenti është zhvillimi dhe përbashkimi i politikave, veprimtarisë së institucioneve e instrumenteve të sigurisë dhe i gjetjes së mundësive e rrugëve më efektive për ruajtjen e paqes, zhvillimin e konsolidimin e demokracisë dhe të interesave.

Strategjia e sigurimit parashtron kushtet e caktuara politike, ekonomike, sociale, të mjedisit dhe ushtarake që kushtëzojnë shkallën e sigurisë së vendit, si dhe rekomandon rrugët më të përshtatshme në aspektin e jashtëm dhe të brendshëm për arritjen e qëllimeve të saj. Ajo është një dokument dinamik, me karakter të theksuar praktik, e hapur për opinionin e brendshëm e të jashtëm dhe që mbështetet në pikëpamjet e politikës shtetërore dhe në parimet ndërkombëtare të sigurimit.

Realizimi i objektivave e kërkesave të këtij dokumenti kërkon një angazhim maksimal në të gjitha nivelet e udhëheqjes shtetërore, arritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik për besueshmërinë e saj, si dhe një mbështetje të mjaftueshme ligjore e vendimmarrëse nga organet përkatëse.

## VENDIM

**Nr.47, datë 17.2.2000**

### **PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TEKNIK TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE TË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË ITALISË, “PËR PROJEKTIN URË PËR ASISTENCË TË MENJËHERËSHME PËR IMPIANTIN E UJIT TË PIJSHËM NË BOVILLË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve publike, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1.Miratimin e memorandumit teknik të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike të Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, “Për projektin urë për asistencë të menjëhershme për impiantin e ujit të pijshëm në Bovillë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Ilir Meta**

Doli nga shtypi më 1.3.2000

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4000 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Tiranë, 2000

Çmimi: 150 lekë